

PRIZRENI DERI TE TANZIMATI (1839)

Emri Prizren gjatë periudhave të ndryshme historike është shkruar në shumë forma: *Prizren, Prezren, Prisreni, Prisrendi, Prizdrijan, Prizdrijana, Prizrin, Prizrend, Prezrin, Porzerin, Perserin, Zer* (*زیر*), *Pirzerin*,¹ *Prisrien, Prisrenum, Presarin, Prisareno* (në përmendoret latine),² *Prizriensis, Приздріява*,³ turqit e quanin *Pürzerin*, kurse shqiptarët — *Përzen*.⁴

Sipas mendimit të Edmund Spencer-it, Prizreni, *Priscopera* e hershme, është themeluar në kohën e Filipit të Maqedonisë. Në kohën romake ai bëhet një nga stacionet kryesore.⁵ Kurse, sipas fra Donatit Jeliq (1650) Prizreni ishte Justiniana e parë (Prisreno prima Justiniana).⁶ Ndërkaq, Pjetër Bogdani (1685) thotë: „*Pirenopoli* i vjetër tash i quajtur Prizrend, nderohet me titullin e Justinianës së dytë në bulën e Urbanit VIII për ngritjen e kolegjes ilirike të Loretos. Kedreni e quan Justiniana II. Është nën administratën e arqipeshkvit të Shkupit megjithëse besohet se ai përfshihet në kufinj të Shqipërisë, gjuhën e së cilës e flet”.⁷

Prizreni kishte edhe këto emërtime: *Prisarin (in Prisarin), Prisarini (castellum Prisarini)*, „*se applicuissse Jorsarim (Preserin)*”, „*Jorsarim (Presren)*”, *Psarin — Presarin, „in Presereno”, „in Pristren”*,

¹ Kosta N. Kostić, *Naši novi gradovi na Jugu*, SKZ, Beograd, 1922, 1; Mehmed Mujezinović, *Natpisi na nadgrobnim spomenicima Suzi-Čelebija i Neharija u Prizrenu*, POF XII—XIII/1962—63, Sarajevo, 268; M. T. Gökbilgin, *XV—XVI asırlarda Edirne ve Paşa livası vakıflar, mülkler, mukataaalar*, IEF, No. 508, Istambul, 1952, fq. 10, 156.

² *Zbornik Konstantina Jirečeka I*, SAN, Beograd, 1959, fq. 281.

³ *Po aty, vërejtja* 216.

⁴ G. I. Elezović, *Rečnik kosovsko-metohiskog dijalekta*, Sveska druga, Beograd, 1953, fq. 134.

⁵ Edmund Spencer, *Travels in Europea Turkey, in 1850. through Bosnia, Servia, Bulgaria, Macedonia, Thrace, Albania, and Epirus*; Vol. II. Coburn and Co., Publishers, London, 1851.

⁶ Injac Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të mesme në shekullin XVII, Vëllimi II, (1634—1650)* Tiranë, 1965, fq. 426, 429.

⁷ *Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, Vëllimi III (1506—1839)*, USHT, IHGJ, Tiranë, 1962, fq. 152.

Preseren, „*merchatoribus demorantibus Prisari (Prisreni?)*”, *Prisarin (p'sari)*, *Prisori*, *Prisarin*;⁸ *Prisdiana*, *Presari*.⁹

Historia e Prizrenit të sotëm daton nga koha e Bizantit, kur iu kanë vënë themelet jo vetëm kalasë, e cila gjendet sipër qytet, por edhe kastelave të tjera të sistemit të gjerë fortifikatash në afërsi të qytetit, të cilat quhen më vonë Dërvengradi apo Donji Gradi dhe Vishegradi, d. m. th. Qyteti i Poshtëm dhe i Sipërm. Prizreni qysh në shekullin XI ishte veç qytet i njohur, meqë përmendet (1096—1105) si seli e ipeshkëvisë (episcopus Prisdrianae) e më 1216 si qytet (Призрѣнь).¹⁰

Konstantin Jireček-u, ndërkaq, është i mendimit se Prizreni është ndërtuar mbi themelet e Therandës antike. Kurse konsulli rus në Prizren, Jastrebov, Therandën e kërkon afër Suharekës, ku ekziston lokaliteti Grazhdanik, respektivisht Ogragjenik.¹¹

Prizreni me rrethinë, gjatë mesjetës, deri sa nuk ra nën sundimin osman, ishte nën qeverisjen e Bizantit, të Bullgarisë dhe të Serbisë, e pastaj edhe nën administrimin e dinastive feudale shqiptare: të Kastriotëve, të Balshajve dhe të Dukagjinëve.

Në kohën e sundimit të Millutinit (1282—1321), i cili i dha rëndësi të veçantë Prizrenit dhe në të — në themelet e një bazilike bizantine — ndërtoi kishën e rëndësishme Uspenia Sv. Bogorodice, që është e njohur si *Kisha e Levishës*. Prizreni, pra, u bë një qendër me rëndësi ekonomike.¹²

Dubrovniku i kishte konsujt e vet në Serbinë mesjetare. Ekzistonte konsulli i përgjithshëm (consul generalis) për gjithë vendin dhe konsujt për një proces gjyqësor, me dy ndihmës (*duo boni homines mercatores*, më vonë *iudices*).¹³ Me vendimin e qytetit të Dubrovnikut (17 tetor 1325) është formuar përfaqësia e përhershme për gjithë shtetin e Serbisë mesjetare, kështu është vendosur një konsull dubrovnikas „*consul mercatorum Ragusinorum, conversantium in Sclavonia*”. Ai është emëruar për një vjet me rrogë prej 400 perperesh. Konsulli nuk ka guxuar të tregtojë, por është dashur të qëndrojë aty ku gjendej mbreti i Serbisë me selinë e tij. Prandaj, konsulli i Dubrovnikut, nga 8 mars 1332 duhej të qëndronte më së shumti në Prizren në shpenzimet e tregtarëve dubrovnikasë të këtij qyteti dhe të tregtarëve dubrovnikasë që jetonin në të gjitha kolonitë e tjera të Serbisë mesjetare.¹⁴ Detyra e konsullit ishte t'i vizitojë të gjitha panairët e vendit (omnes magnes fieras), që sipas kërkesave të tregtarëve dubrovnikasë, ta vizitojë pallatin mbretëror, që t'i vizitojë të gjitha tregjet e vendit (omnia mercata Sclavonie), ku qëndronin dubrovnikasit, dhe ato t'i vizitojë dy herë në vit, dhe t'i gjyko-

⁸ *Zbornik Konstantina Jirečeka I*, fq. 335.

⁹ Gavro A. Škrivanić, *Imenik geografskih naziva srednjevekovne Zete*, Istorijiski institut NR Crne Gore, Titograd, 1959, fq. 90.

¹⁰ *Po aty: Kosova dikur e sot*, Beograd, 1973, fq. 911.

¹¹ *Po aty*, fq. 912.

¹² *Po aty*, fq. 913.

¹³ K. Jireček, *Istorija Srba*, Beograd, II, 1952, fq. 179.

¹⁴ *Po aty*.

jë konfliktet të cilat shpërthenin në mes të bashkatdhetarëve (dubrovnikasve). Ai në disa raste kishte detyrë me përgjegjësi që t'i konsultojë tregtarët e kolonisë dubrovnikase në Prizren. Sekretari i tij ishte një meshtar dubrovnikas, i cili të gjitha aktet konsullare i ka regjistruar në një libër në formë katrore. Kur Prizreni bie, konsullata dubrovnikase ngritet në Novobërdë.¹⁵

Dubrovniku në shekullin XIV, kur u sllavizua plotësisht, pranonte vazhdimisht në rendin e qytetarëve dubrovnikasë edhe banorë vendas të Prizrenit.¹⁶ Në këtë periudhë në Dubrovnik kishin arrihur dy letra të perrandorit S. Urosh të cilat aty ruhen edhe sot. Letra e parë e dt. 10. janar 1357 ishte shpallje e përgjithshme për tregtarët e huaj, dubrovnikasve, venedikasve etj., që gjithkush mund të vijë lirisht në vendin e tij, në Prizren apo në vise të tjera, pa u penguar nga bujarët dhe nga nëpunësit rasasë; e nëse dikush ua rrëmben mallin atëherë perandori atë do ta kompenzojë. Bile-bile as „nëna e Perandorisë, zonja perandoreshe” as vetë perandori nuk do të marrin asgjë pa paguar.¹⁷ Letra e „muajit janar”, pa u theksuar data, por padyshim është e vitit 1357, i është shkruar princit dhe komunës (bashkisë) së Dubrovnikut, me të cilën përsëri garantohet liria e tregtisë dhe vihet në pah se dogana e Prizrenit i është dhuruar kishës Shën-Arhangjelit.¹⁸ Po ashtu, në të njëjtin vit, përfaqësuesit e Dubrovnikut (Marin Bušić, Žive Nikolin Gündulić dhe Žive Črujević) e gjejnë perandorin në Prizren, ku ia dorëzojnë dhuratat dhe i paraqesin ankesat dhe dëshirat e tyre.¹⁹ Nga ana tjetër edhe tregtarët vendas, d. m. th. prizrenasit, me mallrat e tyre shkonin në Dubrovnik për t'i shitur.²⁰ Kjo do të thotë se ishte krijuar edhe shtresa e tregtarëve vendas, prizrenasë (kosovarë). Kolonistët dubrovnikasë të Bërskovës, nga shekulli XIV, shpërngulen për në Prizren, në Novobërdë dhe gjetiu, sepse Bërskova, në atë kohë, bie si vend xehetar me rëndësi që ishte.²¹

Banorë të përhershëm të Prizrenit dhe të rrethinës së saj përmenden, gjatë shekullit XIII—XIV, edhe shqiptarët dhe vllahët.²² Banorët e vetë Prizrenit, pra, ishin: shqiptarët, serbët, vllahët, dubrovnikasit, sasët, kotorasit, korçullanët, splitasit, zarasit, venedikasit dhe firentinasit. Të gjithë këta të fundit ishin të huaj dhe jetonin në kolonitë e tyre, duke gëzuar të drejta të posaçme.²³

Bienë në sy emrat shqiptarë të vendeve në brendësi të Malit të Zi, ku sot askush nuk flet shqip, p. sh, *Shingjon* në Rijekën e Černojeviqve (Crnojevića Rijeka) (Sv. Jovan), *Progoniqët dhe Gojëma-*

¹⁵ *Po aty*, fq. 179, 180.

¹⁶ *Zbornik Konstantina Jirečeka*, I, fq. 220.

¹⁷ *Po aty*, fq. 251.

¹⁸ *Po aty*, fq. 351.

¹⁹ *Po aty*, fq. 352.

²⁰ *Po aty*, fq. 359.

²¹ *Po aty*, fq. 283.

²² Për strukturën e popullsisë së Kosovës më hollësisht shih: S. R i z a j, *Kosova gjatë shekullit XV, XVI dhe XVII*, „Rilindja”, Prishtinë, 1982.

²³ J e f t o D e d i j e r, *Nova Srbija*, SKZ, Beograd, 1913, fq. 255.

dhe (Goljmade) qysh më 1444, „gulae magnaë”), në nahijën e Leshanit (nga shqipja: lesh). Janë karakteristike gojëdhënat mbi prejardhjen e përbashkët të disa fiseve shqiptare dhe malazeze, si p. sh. *Vasijeviqët, Piperët, Ozriniqët, Krasniqët, dhe Hotët*, të cilët ridhënin prej pesë vëllezërve.²⁴ Këto janë të dhëna që flasin në të mirë të asimilimit të shqiptarëve në malazezë nëpërmjet të fesë ortodokse. Pastaj, në rrethinën e Prizrenit, në povelat (aktdhurimet) e Stefan Dushanit, përmenden njerëzit me emra shqiptarë karakteristike të kohës: *Lesh, Gjon, Gjin* etj. Nga fundi i shekullit XIII ka filluar dyndja e shqiptarëve për në jug: në Tesali dhe në Epir, të përkrahur nga pushtimet e Stefan Dushanit. Aso kohe serbët i kanë shfrytëzuar shumë konfliktet shqiptaro-greke.²⁵

Prizreni në shekullin XIV tek dubrovnikasit konsiderohej vetëm si treg (mercado). Në atë kohë, në qytete-tregje ishin tre personalitete kryesore: *qefalia* ose komandanti i fortifikatës, i cili ishte zakonisht serb, *princi* ose *comes* „conte del mercado”, shpeshherë dalmatinas, dhe *doganieri* ose *doanarius*, zakonisht kotoras ose dubrovnikas, të cilët ishin qiramarrës të doganave dhe të institucioneve të të ardhurave. Ndërkaq banorët (borghesani) paraqitnin një hartë shumë të përzier etnografike. Ata ishin: sasë (gjermanë), kotorasë, tivarasë, dubrovnikasë, korçullasë, splitasë, zarasë, venedikasë, firentinasë, shqiptarë, serbë, vlllehë, grekë etj. Çdo grup e kishte ligjin e vet. Pra, qytetarët (hospites) ende nuk ishin shkrirë në një masë të përbashkët qytetare me të drejta të barabarta. Bazën e formimit të këtyre tregjeve nuk e kanë vënë aq kolonitë e tregtarëve të huaj, sa zhvillimi i hovshëm i xehetarisë nga fundi i shekullit XIII.²⁶

Prizreni, për më tepër, ishte vend i rëndësishëm tregtar (mercato) i cili i kishte edhe panairët vjetore. Ky qytet ishte i banuar me tregtarë vendas dhe të huaj, nën ndikimin shpirtëror njëherë të peshkopit, e mandej të manastirit të Arhangjellit, të cilët e kishin vënë Prizrenin nën mbrojtjen e tyre. Katolikët në Prizren kishin dy kapele: „Sancta Maria de Prisren”, ku zakonisht mblidheshin dubrovnikasit, dhe „Sancta Petrus suora Prizren”.²⁷ Në kohë të trazirave, rëndom, tregtarët tërhiqeshin në qytet (castrum). Kështu, në vitin 1332, dubrovnikasit kanë shprehur dëshirën që Stefan Dushani t’ua

²⁴ K. Jireček, *vep. e cit.*, fq. 34.

²⁵ K. Jireček, *vep. e cit.*, fq. 34.

²⁶ *Po aty*, fq. 90.

²⁷ Më 16 dhe 27 korrik 1375 përmendet, në *Diversa Cancellarie 1376* dubrovnikase, „frater Johannes episcopus Presen” ose „Prisrenensis”, i cili, në dhiatën e vet, ia la me testament franjevasve të Stonit katër libra në kishën e Shën-Pjetrit në Dubrovnik me „paramentum album”. Në *Eubel-a Hierarchia catholica medii aevi I* (Münster 1898) 430 numrohen nën „Prishtinen. al. Prisdian. s. Pizrien in Albania”: Contradus 1310 suffraganus episcopi Pragensis, 1313—1320 episcopi Patavinensis; Benedictus Pristicen. (K. Jireček, *vep. e cit.*, fq. 94). Kjo e dhënë nga shekulli XIV, ku përmendet Prizreni në Shqipëri (Prizren in Albania), anipse, në atë kohë, Prizreni gjendej nën administrimin e shtetit të Rashkës, jep të kuptojmë se Prizreni konsiderohej, sigurisht për shkak se aty mbizotëronte elementi etnik shqiptar, si vend në Shqipëri, d.m.th. trevë e shqiptarëve.

besojë atyre, si kolonistë që ishin, ruajtjen e Prizrenit për shkak të sigurimit më të madh, si vetë atyre (dubrovnikasve) ashtu dhe të mallit të tyre.²⁸ Mirëpo, kur dinastia e Nemaniqve u shua, në vitin 1372 konti (zhupan) Nikola Altomanoviqi (Nikola Altomanović) me ushtritë e veta i afrohet Prizrenit, dubrovnikasit nga Prizreni fshehen (ngujohen) në manastirin e afërm të Shën-Arangelit (ecclesia Sancti Archangeli) dhe në fortifikatë (kala).²⁹ Si rezultat i këtyre luftërave Prizreni fillon të bie me të madhe, i cili më parë kishte përparuar shumë.³⁰

Me fjalë të tjera, në vitin 1372 ndodhen ndryshime të mëdha në Ballkan, pra, edhe në Kosovë, si pasojë e betejës së Maricës (1371). Më 14 maj 1372 papa Gërguri XI i shkroi nga Avinjoni mbretit të Hungarisë, Ludvigut, që para një kohe (diebus siquidem non longe preteritis) arritën në selinë papnore lajme të ndryshme, që turqit-osmanë me një ushtri të madhe kanë sulmuar viset greke, që i kanë nënshtruar disa fisnikë të Rashkës (subactis quibusdam magnatibus Rascie) dhe, duke marrë shumë vende, kanë arritur madje deri te kufijtë e Serbisë, të Hungarisë dhe të Shqipërisë, si dhe i kanë rrezikuar brigjet e Adriatikut. Diçka më vonë papati është njohuar se turqit-osmanë kanë depërtuar deri në Greqi, në Vllahi dhe në Rashkë (contra nonnullos mognotos et populos partium Grecie, Walachie et regni Rascie obtinuerant grandem victoriam", dhe duke i nënshtruar ato krahina, iu kanë afruar „usque prope fines dicti regni Rascie ac Albanie, ac principatus Achaie et ducatus Athenarum" (Rashkës, Shqipërisë, principatës së Rashkës dhe të dukatës së Athinës), prandaj, janë ftuar në kuvendin në Tebë të Beotisë, me Vulën (dekret i papatit) e 13 nëntorit 1372: zotërinjtë frengë në Greqi, mbreti i Hungarisë dhe i Sicilisë, Bashkia e Venedikut dhe e Gjenovës si dhe zotërinjtë e tjerë.³¹ Në këtë mënyrë papa nuk mendonte vetëm për të luftuar, por edhe për t'i pushtuar vendet apo krahinat e feudalëve rasasë, maqedonë dhe shqiptarë, të cilët e kishin pranuar vasalitetin e turqve-osmanë, si bi fjala i biri i Vukashinit, kral Marku, vëllazërit Dejanoviq etj. Kështu, feudali shqiptar, Gjergj Balsha, sipas të gjitha gjasave, i përkrahur nga papati, pushtoi shumë vise të Shqipërisë, madje edhe Prizrenin dhe Pejën.³²

²⁸ K. Jireček, *vep. e cit.*, fq. 94, 95.

²⁹ Procesi gjyqësor për shkak të humbjes së disa thasve të argjendit në Dubrovnik më 14 janar 1373: „Lamentationes de foris" 1370—1373. (Arhiv. Dubrovnik). Prizrenin atëherë e ka marrë Gjergj Balsha. (K. Jireček, *vep. e cit.*, fq. 95).

³⁰ K. Jireček, *vep. e cit.*, fq. 95.

³¹ Theiner, *Monumenta Hung.* II, 115. — Wenzel. *Mon. Hung. Acta extera III* 40; nëpërmjet të: Zbornik Konstantina Jirečeka I, fq. 378.

³² Nga burimet e Venedikut kuptojmë se Gjergj Balsha në verë të vitit 1372 bëhet edhe sundues i Vlorës. (Ljubić, *Mon.* IV 100 e më tutje; nëpërmjet të: Zbornik Konstantina Jirečeka, I, 379). Lidhur me këto çështje shih edhe: Yilmaz Öztuna, *Büyük Türkiye Tarihi*, II, Istanbul, 1977, fq. 290—293, 316—317; *Osmanlı İmparatorluğu Tarihi*, Başlangıçtan 1566'ya kadar), „Havas". Istanbul, 1978, fq. 104, 105; İsmail Hami Danişmend, *İzahlı Osmanlı Tarihi Kronolojisi*, I. Türkiye Istanbul (Nuk ka vit të botimit), fq. 53—55.

Për këtë arsye, pra, tregtarët e Dubrovnikut, të cilët aso kohe gjendeshin në Prizren, në atë rast, Gjergj Balshës ia dhurojnë katër pancirë. Lidhur me këtë Qeveria e Dubrovnikut, më 10 shtator 1372, mori vendimin që vlerën e kësaj dhurate, nga 5 livra argjendi për pancirë, do ta kompensojnë drejtorët e këtyre shtëpive tregtare, të cilat tani gjenden në Prizren dhe e dhanë këtë dhuratë.³³ Gjergj Balsha, nga ana tjetër, disa dubrovnikasve iu dha me qira doganën e Prizrenit.³⁴

Pikërisht edhe burimet osmane i vërtetojnë pohimet e papatit. Sepse, vërtet, akinxhinjtë,³⁵ duke kaluar Vardarin, kalojnë në Serbi, Bosnjë, Shqipëri, madje-madje depërtojnë deri në Dalmaci (1372).³⁶ Me fjalë të tjera dy dinasti shqiptare, Balshajtë dhe Topiajtë, duke filluar qysh në shekullin XIII u përpoqën të paverësohen nga sundimi i të huajve, dhe të formojnë një shtet shqiptar të centralizuar, por më kot. Ndërkaq në shekullin XIV, në luftë kundër depërtimit osman u shquan dy familje feudale shqiptare: Kastriotët dhe Arianitët.³⁷

Pra, shteti-principata shqiptare në krye me Gjergj Balshën, përfshiu një territor mjaft të gjerë. Por, bërthama e kësaj principate ishte rrethina e Tivarit, e Budvës dhe deri në Liqenin e Shkodrës, e kufinjtë e saj shtriheshin madje nga Dubrovniku dhe Kotori e deri te Prizreni,³⁸ e Vlora.³⁹ Mirëpo, Gjergj Balsha I, i cili u përpoq ta bashkojë Shqipërinë, me qendër në Shkodër, pas luftërave të shumta, vdiq në vitin 1379 (781 H.).⁴⁰ Gjergj Balshën I e trashë-

³³ Më 10 shtator 1372 „determinatum fuit quod coracias III, que fuerunt donate Jure de Balsa, vallonis librarum V de argento coracia siue panceria, per mercatores in Prisreno, quando dictus Jura cepit castrum dicti loci, debeant solui per capita domorum mercatorum, qui tunc habitabant in Prisreno, et hoc ad petitionem Dymitri de Benessa tamquam procuratoris Pocre de Benessa”. *Div. Canc. 1376. (Zbornik Konstantina Jirečeka, I, fq. 379, vërejtja 111.)*

³⁴ Kosta N. Kostić, *vep. e cit.*, fq. 3, 4.

³⁵ Akinxhi (akinci) ishte një farë kalorsie osmane, e përbërë nga turqit dhe shqiptarët në pikëpamje etnike, e akinxhillëku ishte trashëgues, d.m.th. kalohej nga babai në të bririn. Këta bënë sulme, inkursione, në tokat e huaja; ato i dobësonin, i plackitnin dhe banorët e atyre i zinin robër. Kjo kategori e ushtrisë osmane, e cila luajti rol të rëndësishëm në pushtimet osmane, nga fundi i shekulit XVI e humbi rëndësinë e saj.

³⁶ Ismail Hami Danişmend, *vep. e cit.*, fq. 53, 54.

³⁷ *Po aty*, fq. 67, 68.

³⁸ Konstantin Jireček, *Istoriya Srba*, II, fq. 320.

³⁹ Mbi shtrirjen e principatës së Gjergj Balshës deri te Dubrovniku dhe detyrimet (taksat) që i jepte Dubrovniku Gjergj Balshës shih: *Zbornik Konstantina Jirečeka, I, fq. 248, 380—382.* (Se Zura de Balsa te domandara, ad che Crassoe venne con alcuni de Tribingna in Ragusa et da parte de Messir lo bano de Bossina, lo detto Crassoe retornasse a Ragusa, che fuse pleço per la bano a quelli de Tribungna, che lo bano lo osseruasse tutto quello che lor promettesse, et li zintili de Ragusa non se volse niente inpaçar de questi seruiçii, perzo che auemo voy per amico et lo bano per amico etc. Commissio 23 febr. 1377, Lett. l. c.f. 106') (*Po aty*, fq. 382.)

⁴⁰ Ismail Hami Danişmend, *vep. e cit.*, fq. 107. (Şimalî Arnavutluk' da Işkodra'yı merkez ittihaz ederek tutunan Balşa ailesinden Birinci

goi i vëllai i ri Balsha II, i cili në vitin 1385, në luftë kundër osmanëve, në betejën e Savrës u vra. Balshën II e trashëgoi nipi Gjergj Balsha II Strasimiri (Strasimir Gjergji).⁴¹ Beteja në fushën e Savrës, fushë kjo e cila gjendet në anën e majtë të lumit Devoll, në rrethinën e Elbasanit, ishte, në të vërtetë betejë e cila i siguroi osmanëve fitoren e parë në Shqipëri. Në këtë betejë, në aleancë me shqiptarët, morën pjesë edhe serbët. Bile, në këtë betejë u vra, së bashku me Balshën II, edhe njëri nga të bijtë e princit serb Vukashinit, Ivaniqi. Kështu, nga kjo ngjarje mund të konsiderohet se në Shqipëri filloi pushteti osman.⁴² Nga ana tjetër, në betejën e Ploçnikut (1386) në Toplicë, te Prokupla, nga ana e Llazar Grebljanoviqit morën pjesë edhe shqiptarët,⁴³ sigurisht shqiptarët e Toplicës dhe të Kosovës. Në këtë betejë, sipas shënimeve osmane, u vranë 15.000 ushtarë osmanë. Beteja e Ploçnikut, tamam, u bë shkaktare për krijimin e aleancës ballkanike kundër depërtimit osman në brendësi të Ballkanit, në të cilën aleancë, në Betejën e I të Kosovës (1389) morën pjesë edhe disa feudalë shqiptarë (Gjon Kastrioti, Gjergj Balsha II Strasimiri, etj.). Ndërkaq, shqiptarët e Kosovës që morën pjesë në këtë betejë u komanduan nga dhëndurët e Llazarit, Vuk Brankoviqi dhe Millosh Kopiliqi.⁴⁴ Në këtë kohë, fillon të shquhet edhe dinastia e Dukagjinëve, e cila kishte një pjesë të Shqipërisë Veriore, sidomos Mirditën.⁴⁵

Ndërkaq, sipas mendimit të Jovan Radoniqit, krajina e Vuk Brankoviqit, njëherit përfshinte Prishtinën, Vuçitërnën, Zveçanin dhe Trepçën. Në vitin 1365 krahina në mes të Prizrenit dhe të Prishtinës hyri në suazën e principatës së Vukut. Ndërkaq, pas vdekjes së Gjergj Balshës (1378),⁴⁶ Vuk Brankoviqi në kuadrin e principatës së vetë përfshin edhe vetë Prizrenin. Në përfundim, — thotë Jovan Radoniqi, — Krahina e Vukut shtrihej deri te lumi Lim. Vuku në vitin 1377 e mbante edhe Shkupin. Më vonë, krahina e Vukut është zvogëluar shumë. Më 1391 turqit (osmanët) e pushtuan Shkupin dhe kështu, më 1395, vejushës së Llazarit ia dorëzuan rrethinën e Pejës dhe të Deçanit.⁴⁷

Nga ana tjetër historiani i mirënjohur serb Mihailo Diniçi është i mendimit që për Prizrenin, si qytet i Vukut, nuk ka dëshmi

Georges Balşa Arnavut birliği uğrunda bir çok muharebelere giriştiği sonra 1379=781 tarihinde ölmüş ve yerine küçük kardeşi İkinci Balşa geçmiştir: 1385=787 tarihindeki Savra zaferi işte buna karşı kazanılmış (*Po aty.*)

⁴¹ İsmail Hami Danişmend, *vep. e cit.*, fq. 107, 108.

⁴² *Po aty*, fq. 68.

⁴³ *Po aty*, fq. 75.

⁴⁴ *Po aty*, fq. 75, 108; Ahmet Salâhaddin Akan, *İkinci Viyana Kuşatma Kararı*, Dizgi Yeni Gür Matbaası, İstanbul, 1970, fq. 413; Şerif Baştav, *16. Asırda Yüzyılmış Grekçe Anonim Osmanlı Tarihi*, Giriş ve Metin (1373—1512), AÜ DTGF, Ankara, 1973, fq. 93—96.

⁴⁵ *Po aty*, fq. 108. Për Balshajt, Kastriotët, Dukagjinët dhe Brankoviqët, më hollësisht, shih: S. Rizaj, *Kosova gjatë shekullit XV, XVI dhe XVII*.

⁴⁶ Si u cek më lart, sipas burimeve osmane, Gjergj Balsha vdiq në vitin 781 H. (1379).

⁴⁷ K. Jireček, *Vep. e cit.*, fq. 321.

FAMILJA E BALSHAJVE

Më 1360 krijohet principata e Balshës I



të drejtpërdrejtë. Kështu është fjala edhe për Pejën.⁴⁸ Vetëm regjistrimi i vitit 1455 tregon qartë se cilat territore i përfshinte Krahina e Vukut. Sipas këtij defteri Krahina e Vukut nuk e përfshinte fare Prizrenin, Gjakovën dhe Pejën me rrethinë, respektivisht nuk e ka përfshirë Rrafshin e Dukagjinit, d. m. th. nuk shtrihej në luginën e Drinit të Bardhë. Ajo shtrihej deri në Klinë në perëndim, deri në Leskovc në lindje, deri në Karadakun e Shkupit në jug dhe deri në Rozhajë në veriperëndim.⁴⁹

Mirëpo, sipas të gjitha gjasave, Prizreni në shekullin XIV dhe XV, njëherë ishte nën administrimin e Gjon Kastriotit, e pastaj të Dukagjinëve. Prizreni ka mundur të futet në suazën e principatës së Gjon Kastriotit pas betejës së Savrës (1385), me ç'rast u vra Balsha II dhe u dobësua shumë principata e Balshajve. Sepse, sipas disa të dhënave historike, aso kohe familja e Kastriotëve i zgjeron territoret e veta edhe në viset prej kepit të Rodonit në perëndim deri te malet e Sharrit në lindje, nëpërmjet të cilave territore kalonte rruga tregtare nga bregdeti deri në Prizren.⁵⁰ Ky territor, nëpërmjet të të cilit kalonte rruga nga Shkodra për në Prizren, — siç thotë Kostantin Jirečeku, në mesjetën e hershme i takonte Pilotit; në shekullin XIV njëherit ishte në pronësi të Kastriotëve,⁵¹ kur-

⁴⁸ Mihailo Dinić, *Srpske zemlje u srednjem veku*, SKZ, Beograd, 1978, fq. 149, 151.

⁴⁹ H. Hadžibegić — A. Handžić — E. Kovačević, *Oblast Brankovića — Opširni katastarski popis iz 1455. godine*, OIS, Sarajevo, 1972.

⁵⁰ K. Jireček, *vep. e cit.*, fq. 321.

⁵¹ Më 1430 kanë bashkëbiseduar dubrovnikasit me turqit-osmanllinj në të mirë të interesave të tregtarëve të vet në Novobërdë dhe në Prishtinë mbi kalim të lirë „per la contrada fo de Juan Castrioti ad Alexio” (*Zbornik Konstantina Jirečeka*, I, fq. 280, vërejtja 213b).

se më vonë Dukagjinëve, emri i të cilëve edhe sot e kësaj dite përdoret si emërtim i kësaj krahine (Rrafshi i Dukagjinit).⁵² Gjon Kastrioti në shkresën e vet të 20 shkurtit 1420 drejtuar Dubrovnikut, në mes tjerash thotë, „ТКО ОУСХОК МИНОВТИ МООМЪ ЗЕМЛОМЪ ОУ ЗЕМЛЮ ГЮРГЕВОВОУ или господина деспота“, dhe pastaj, Gjoni shton te se do t'i kompenzonte dëmet eventuale të tregtarëve „deri në Prizren“.⁵³ Nga kjo e dhënë, mendoj, duk duhet kuptuar se Prizreni përfshihej në kuadrin e despotisë së Rashkës të Gjergj Brankoviqit, por ai gjendej mu brenda kufinjve të principatës së Gjon Kastriotit, sepse Gjoni tregtarëve dubrovnikasë u siguronte kushte normale për punë „deri në Prizren“, d. m. th. përfshinte edhe Prizrenin, sepse përtej Prizrenit, pra jashtë Rrafshit të Dukagjinit — në Kosovë në kuptimin e ngushtë të fjalës qeveriste Gjergj Brankoviqi, ku ekzistonin — në Novobërdë, në Janjevë, në Prishtinë dhe në Trepçë, edhe në atë kohë, kolonitë dubrovnikase. Zaten, gjykuar nga dokumenti në fjalë i vitit 1420 deri te Prizreni (duke përfshirë edhe Prizrenin) ishte toka e tij, kurse përtej Prizrenit, deri në Novobërdë e gjetiu ishte toka e Gjergj Brankoviqit.

Si duket, pas vdekjes së Gjon Kastriotit, Prizreni me Rrafshin e Dukagjinit, hynë nën qeverisjen e dukagjinasve. Për më tepër, kronisti dhe humanisti shqiptar i kohës, Marin Barleti, nënvizon sa vijon: „Ky Pali, siç e kemi përmendur, ishte atëherë një princ jo i panjohur në Epir dhe me fuqira, për të cilat s'mund të ishte i pakënaqur; veç kësaj ai ishte shumë i nderuar nga të gjithë sepse i dhënë disi më me shpirt se sa të tjerët pas besimit, dhe prej një dere fisnike, nga e cila kanë dalë kaqë kapedanë shumë trima, veçanërisht Nikolla, bir i Palit, që, për nga lavdia luftarake, i ka kaluar shumë nderet e t'et dhe të parëvet të vet. Një përmendore e këtij trimi të pathyeshëm me atë të djathtën e tij, si t'i themi, të pavdekshme ndodhet ende sot në Peneropolis (Praeserem), qytet i Thrakisë, të cilin sot vendasit e quajnë Prizren; mbi të janë varur mbeturinat e një mburoje armike, të cilën, në një betejë që është ende e freskët në kujdesin e njerëzve, Nikola e çau aqë me goditjen e shpatës së vet, sa që edhe dorën e armikut luftëtar e bëri të pavlefshme për luftë“.⁵⁴

Në Prizren, në kohën e mbretit Vukashin (1370), janë prerë edhe monedhat (cecha de Prisreno).⁵⁵ Pastaj, qysh nga koha ilire, në Prizren ishte ruajtur tradita e shpërlarjes së arit, d.m.th. nxjerrjes së thermijave të arit nga lumi i Bistricës. Kjo veprimtari përmendet edhe në aktdhurimin e Stefan Dushanit për manastirin e Arhangjelit në Prizren.⁵⁶

⁵² Zbornik Konstantina Jirečka, I, fq. 280.

⁵³ Mihailo Dinić, *Srpske zemlje u srednjem veku*, Beograd, 1978, fq. 150, 168.

⁵⁴ Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skenderbeut*, Tiranë, 1964, fq. 119.

⁵⁵ K. Jireček, *Istorija Srba*, II, fq. 202.

⁵⁶ *Po aty*, fq. 173.

Tregtarët prizrenasë përmenden që nga viti 1298; disa nga emrat e tyre janë karakteristikë shqiptarë të kohës: *Drasisclavus Rubini* (sufiksi „i” i shqipës — S. R.) më 1298, i ka borxh dubrovnikasit *Fuscho de Luchiari*⁵⁷ 460 perpera qysh ka herë, *Pervosclavus Dobrovich* më 1324 blen kuaj, *Bosich Rupceovich* dhe *Deco Decomano-sit* (?)⁵⁸ më 1333 tregtojnë në Nish dhe në Dubrovnik, *Theodorus Liepich* më 1355—1369, *Lumasius*⁵⁹ më 1364, *Bosich Bochdisevich* 1365—1369, *Dymitrus Todorçevich* 1365, *Mladousius de Prisreno* 1365, *Roman Dominchovich* 1365, *Petre Terteliça*⁶⁰ dhe *Brajan*⁶¹ *Vasilovich* 1368, *Bogdanus filius quondam Rayci Chirismich* (Quirismich, de Chirisma)⁶² 1368, *Ivancho Dimitrovich Drievodellich* 1366, *Boychho Radussich* dhe *Maycho frate Draghië* 1369, *Rad. Borislavich* 1369, *Dessillus Dabisivovich* 1369, *Voynus Jonovich* (arb. Gion=Jovan),⁶³ *Liepur de Prisreno*⁶⁴ 1369, *Doycus Varilovich* dhe *Bositcus filius Raychi*⁶⁵ *Varilovich* 1369, *Dobrosclavus Nicolich* 1370, *Jonçe Sara-chinovich*⁶⁶ 1371, *Jorgy Marcovich* 1375 etj.⁶⁷ Mjeku nga Prizreni „*Milcunus de Presarin* (Prizren), homo domini imparatoris” zotohet që në Dubrovnik, në nëntor të viti 1349, për një shpërblim prej 20 perperesh, do t’ia mjekojë të birin këpucëtarit Medoj, i cili ishte sëmurë nga guri (morbus lapidis, qui dicitur malum de petre).⁶⁸

Kur sulltan Murati II e sulmoi Despotinë serbe (1427), dubrovnikasit e Novobërdës dhe të Prizrenit luftuan kundër turqve-osmanë.⁶⁹ Mirëpo, më 1433 Prizreni përmendet si vend tregtar i braktisur.⁷⁰

Prizreni, ndërkaq, nën sundimin osman ra disa herë gjatë shekujve XIV dhe XV. Por, rënia definitive e tij, sipas një versioni, u bë më 1456,⁷¹ kurse sipas disa të dhënave osmane — më 1459.⁷²

Pas rënies definitive të Prizrenit nën sundimin osman, pra, formohet Sanxhaku i Prizrenit, si njësi administrative, e cila përfshinte një territor mjaft të gjerë. Ky sanxhak, për më tepër, luajti rol të rëndësishëm në historinë e një pjese të madhe të Kosovës.

⁵⁷ Fusho Lukari, emër karakteristik shqiptar. Në të vërtetë tregtarët Lukari të Dubrovnikut konsiderohen me origjinë shqiptare.

⁵⁸ Sufiksi i shqipës.

⁵⁹ Si duket është fjala për ndonjë Lumjan.

⁶⁰ Emër dhe mbiemër karakteristik shqiptar.

⁶¹ Emër karakteristik shqiptar për kohën.

⁶² Emër dhe mbiemër karakteristik shqiptar.

⁶³ Shqiptar.

⁶⁴ Lepur Prizreni emër shqiptar.

⁶⁵ Sufiksi i shqipës.

⁶⁶ Edhe sot e kësaj dite kemi familje shqiptare myslimane me mbiemër Saraqini.

⁶⁷ K. Jireček, *vep. e cit.*, fq. 179.

⁶⁸ *Po aty*, fq. 314.

⁶⁹ Bogumil Hrabak, *Izvoz žitarica iz Osmanskog Carstva u XIV, XV i XVI stoljeća*, ZNUK, Priština, 1971, fq. 49.

⁷⁰ K. Jireček, *vek. e cit.*, fq. 425.

⁷¹ *Po aty*, fq. 327.

⁷² Mbi rënien definitive të Prizrenit nën sundimin osman gjerësisht shih: S. Rizaj, *Kosova gjatë shekullit XV, XVI dhe XVII*.

Kështu, në vitin 1485 në sektorin (vilajet) e xhizjes⁷³ së Prizrenit kishte 17.600 shtëpi xhizjedhëse (*hanë* dhe *bîve*)⁷⁴ të krishtera. Xhizjembledhësi ishte Muhameddin bin Altun.⁷⁵ Ndërkaq, me 1490 Sanxhaku i Prizrenit përfshinte një territor shumë të gjerë, duke u ndarë në 7 vilajete:⁷⁶ Jeni Pazari, Tërgovishta (Rozhaja), Prizreni, Bërveniku, Bihori me Suho-Gërlën, Komnini dhe Vllehët e Prizrenit⁷⁷ (Dragashi — Malësia e Prizrenit — S. R.). Në këtë territor kishte 22.127 shtëpi „hane”, 1.845 shtëpi të riregjistruara, 1.721 shtëpi të zhdukura, 1 shtëpi e myslimanizur, 1.859 shtëpi „bîve”. Prej tyre në vilajetin e Prizrenit ishin: 5.701 shtëpi „hane”, 387 shtëpi të riregjistruara, 485 shtëpi të zhdukura, 660 shtëpi „bîve”.⁷⁸

Me fjalë të tjera Sanxhaku i Prizrenit më 1491 kishte 23.970 shtëpi „hane”, me një sipërfaqe prej 11.475 km², ose 2,52% për kilometër katror.⁷⁹ Ndërkaq, në vitet 1520—1530 Sanxhaku i Prizrenit përfshinte 18.382 shtëpi „hane”, me familje të krishtera, të cilat ishin paguese të taksës avariz. Sanxhaku në fjalë ngërthente një sipërfaqe prej 11.475 km². Dëndësia ishte 1,60 shtëpi „hane” për një kilometër katror.⁸⁰ Meqenëse tani paraqitet numri i zvogëluar i shtëpive, na bën të kuptojmë se një pjesë e konsiderueshme e shtëpive krishtere ishin myslimanizuar.

Pra, sipas, defterit të vitit 1530 të ndarjes administrative të Ejaletit të Rumelisë, Sanxhaku i Prizrenit së bashku me Hasin shqipëtar, që gjendet në afërsi, ndahet në katër kaza.⁸¹

Së këndejmi, në vitet 1520—1535 pasqyra etnike-fetare e Sanxhakut të Prizrenit ishte kjo: 18.382 shtëpi jomyslimane, ose 98%, 359 shtëpi myslimane ose 2%. Numri i përgjithshëm ishte 18.741 shtëpi.⁸² Kjo do të thotë se Sanxhaku i Prizrenit në fillim të shekullit XVI kishte afro 200.000 banorë. Ky numër është i madh për kohën e sotme, e aq më tepër për atë kohë, kur numri i banorëve në

⁷³ Xhizje ishte taksë të cilën e paguanin të krishterët meshkuj të aftë për ushtri si ekuivalent për shërbim në ushtri. Krishterët duke e paguar këtë taksë nuk shërbenin në ushtri, siç ndodhte me meshkujt myslimanë. Kjo taksë paguhej varësisht nga shkalla e pasurisë. Mirëpo, edhe të krishterët, që nuk ishin të aftë për shërbim ushtarak dhe shërbenin në forma të ndryshme në të mirë të sistemit shtetëror të Perandorisë Osmane liroheshin nga kjo farë takse.

⁷⁴ *Hane* ishte familja me kryefamiljar mashkullin, kurse *bîve* ishte familja me kryefamiljar gruan vejushë.

⁷⁵ M. T. Gökbiğın, *XV—XVI. asırlarda Edirne ve Paşa Livası, vakıflar, mülkler, mukataalar*, IEF, No. 508. Istanbul, 1952, fq. 157.

⁷⁶ Vilajeti në këtë rast është njësi administrative më e vogël se sanxhaku, është si një farë rrethi.

⁷⁷ Kuptimi vllah me këtë rast ka kuptim social, d.m.th. është fjala për blegtorët, për malësorët të cilët merreshin kryesisht me blegëtori.

⁷⁸ N. Todorov, *Za demografskoto s'stojanie na Balkanskiya poluostron prez XV—XVI vek*. Godišen na Sofiskaja Universitet, Tom LIII, 2, Sofia, 1960, fq. 206.

⁷⁹ *Po aty*, fq. 211.

⁸⁰ *Po aty*, fq. 212.

⁸¹ M. T. Gökbiğın, *vep. e cit.*, fq. 10.

⁸² Enver Dukagjini, *Gradska naselja Metohije (Dukagjina)*, Priština, 1978, fq. 74.

Evropë ka qenë shumë i vogël në krahasim me dendësinë e bano-
rëve të Sanxhakut të Prizrenit të asaj kohe.

Vakëfnameja e Suzit nga viti 1513 është një nga dokumentet më të vjetra të vendit për historinë e Prizrenit. Ky dokument tregon përparimin e Prizrenit në fillim të shekullit XVI. Sipas tij, prizrenasi i mirënjohur Suzi Çelebiu (Mevlana efendi ibn Mahmud ibn Abdullah), historian, udhëpërshkrues dhe poet, ka ndërtuar në Prizren një xhami dhe një shkollë fillore, së cilës i ka falur disa libra, kështu që kjo do të ketë qenë ndër bibliotekat e para në Kosovë.

Nga kjo vakëfname e Suzit kuptojmë sa vijon: se Suzi ishte një nga shkencëtarët-humanistët më të vjetër prizrenas, gjithsesi shqiptar, i cili la pas vetes vepra-shkrime nga historia, kronika dhe poezia. E, meqë e mbante titullin çelebi, atëherë ky i takonte shtresës aristokrate të prizrenasve të lashtë, sepse çelebi do të thotë princ. Suzi ishte, siç po shihet nga mbiemri, i biri i Mahmudit, e Mahmudi ishte i biri i Abdullahut (rob i Zotit-Allahut). Emri Abdullah i jepej emër i dytë të krishterit, i biri i të cilit islamizohej, në mënyrë që të mos përmendej emri i vërtetë krishter babait të të islamizuarëve. Pastaj, Suzi jo vetëm që ndërtoi shkollë në Prizren, por në të e formoi edhe biblioteken së cilës i dhuroi disa libra. Kjo bibliotekë duhet llogaritur jo vetëm si një nga bibliotekat më të vjetra të Kosovës, por edhe e gjithë kontinentit të Evropës, duke pasur parasysh faktin se në këtë kohë në shtetet evropiane, pos disa bibliotekave shumë të varfëra mbretërore, nuk kishte biblioteka të qyteteve.

Gjafë shekullit XVI Prizreni zhvillon edhe më shumë tregtinë, zejtarinë dhe jetën kulturo-arsimore. Në atë kohë në Prizren ndërtohen mullinj, dyqanet, karvansarajet, shkollat, xhamitë dhe zgjerohet çarshia. Në këtë mënyrë vetëm Mehmed Hajredin Kukli-beu kishte 117 duqane, 6 mullinj dhe 1 karvansaraj. Kukli beu kishte ngritur dy xhami (1538). Aty ishin edhe shkollat për fëmijë të besimit mysliman. Kah mesi i shekullit XVI Mehmed pasha ndërtoi edhe një haman të madh, dhe një xhami, e cila konsiderohet si një nga godinat më të bukura në vend. Ai ka ndërtuar atëherë edhe një medrese.⁸³

Prizreni në kohën e vezirit të madh Rrustem pashës (I. 1544—1553, II. 1555—1561) kishte 4 mëhallë të mëdha myslimane dhe 12 të vogla krishtere, mëhallë këto që ishin në pjesën më të madhe të banuara nga blegtorët shqiptarë.⁸⁴

Prandaj, këto të dhëna të administratës osmane, sipas të cilave në Prizren ishin katër mëhallë të mëdha myslimane dhe 12 të vogla krishtere shqiptare, dëshmojnë se në mesin e shekullit XVI në këtë qytet mbizotëronte elementi shqiptar.

Ndërkaq, defteri i hollësishëm i Sanxhakut të Prizrenit i vitit 1590/91 jep të dhëna se Prizreni ishte has (dirlik, pronë për shfrytëzim) i sanxhakbeut të Sanxhakut të Prizrenit. Vetë Prizreni ndahet në këto mëhallë:

⁸³ *Po aty.*

⁸⁴ *Hatib*: fetar që këndon *hytbën* në xhami; ligjërues, orator.

1) *Mehalla e xhamisë së vjetër*, e cila kishte 53 shtëpi. Kryefamiljarët ishin: hatibë, myezinë, nalbandë (mbathtarë), samarxhinj, katibë (sekretarë, shkruer), attarë (farmacist, barnator), tregtarë, kazasë,⁸⁵ massahë (gjeometër), bukëpjekës, saraçë, dellakë,⁸⁶ bazhdarë.⁸⁷ Të gjithë këta ishin të besimit mysliman. Pra, në këtë mehallë ishin këta kryefamiljarë: 1. Vejsi, halife (kallfë) hatib; 2. Mustafa, myezin; 3. Ali, nalband; 4. haxhi Mahmud; 5. Hysein, nalband; 6. Hydaverd Abdullah (i islamizuar); 7. Husein, samarxhi; 8. Gjijvan, saraç; 9. Nasuh Abdullah (i islamizuar); 10. haxhi Husein; 11. Ahmed Abdullah (i islamizuar); 12. Hysein Abdullah (i islamizuar); 13. Xhafer Abdullah (i islamizuar); 14. Mustafa Abdullah (i islamizuar); 15. Hasan Abdullah (i islamizuar); 16. Sylejman Abdullah (i islamizuar); 17. Nasuh Abdullah (i islamizuar); 18. Mustafa Abdullah (i islamizuar); 19. Hëzër Jusuf; 20. Xhafer Abdullah (i islamizuar); 21. Mustafa, katip; 22. Oruxh, cigan (jevg); 23. Hasan, attar (barnator); 24. Hasan, tregtar; 25. Hasan, hajat (rrobaqepës); 26. Safer, hajat; 27. Mehmed Hasan; 28. Ibrahim, kazaz; 29. Dervish Abdullah (i islamizuar); 30. Hasan Abdullah (i islamizuar), i varfër; 31. Mehmed Abdullah (i islamizuar); 32. Velik Kurdi; 33. Ali, tregtar; 34. Halil Hysein; 35. Hysein, cigan, i varfër; 36. Ibrahim, messah (gjeometër); 37. Mustafa, habbas (bukëpjekës); 38. Mustafa, nalband; 39. Mahmut Xhafer; 40. Mustafa, nalband, tjetër; 41. Sylejman, nalband; 42. Mustafa, habbas (bukëpjekës, furrar); 43. Iljas, samarxhi; 44. Ahmet, nalband; 45. Mustafa, dellak (tellak); 46. Mustafa, nalband; 47. Dervish Gjijvan; 48. Hasan habbas (bukëpjekës), 49. Hasan, bazhdar; 50. Ahmed Basli; 51. Mehmed Behrami; 52. haxhi Hasan; 53. Inebegi Ramazan. Gjithsej: 53 shtëpi (familje).

2) *Mehalla Levisha* përbëhej prej 50 shtëpish, me besim myslimanë. Kryefamiljarët ishin: imamë, myezinë, naibë (zëvendës kadiu), kazasë, berberë, arabaxhinj, ipekçinj (mëndafshtarë), nalbandë, habbasë (furrëtarë), muratorë, saraçë, shpatëfarkues, kasapë, samarxhinj, korjerë, hallvaxhinj, dijetarë, dellakë. Në këtë mehallë, pra, përmenden kryefamiljarët: 1. Ali halife, imam; 2. Mehmed halife, imam; 3. Ahmed halife, myezin; 4. Ahmed halife, myezin, tjetër; 5. Ramazan, halife, myezin; 6. Omer halife, naib; 7. Hysein, hajat (rrobaqepës); 8. Abraham, kazaz; 9. Hysein, borazan;⁸⁸ 10. Hasan, opon (opingar), i varfër, „mücerret” (beqar); 11. Hasan, berber; 12. Hëzër, arabaxhi; 13. Memi, ipekçi, beqar; 14. haxhi Sinan; 15. haxhi Kasëm; 16. Haxhi, nalband; 17. Iljas, habbas; 18. haxhi Tajib; 19. Mustafa Petri (Pjetri); 20. Hysein, dylger (murator); 21. Xhafer, arabaxhi; 22. Ahmed, arabaxhi; 23. Ali, nalband; 24. Mahmud, saraç; 25. Hasan, saraç; 26. Mahmud, këllëçxhi (shpatëfarkues); 27. Hysein,

⁸⁵ *Kazaz*: zejtar qendistar që tirte tehrija për veshje vendase.

⁸⁶ *Dellâk (tellak)*: njeriu i cili në hamam i lan, i fërkon myshterinjtë.

⁸⁷ *Bazhdar (turq. bajdar)*: tagrambledhës, grumbullues i baxhit.

⁸⁸ *Borazan (boruzen)*: trumbetar: ai që i bie trumbetës, ai që i bie borisë.

kasap; 28. Mustafa, samarxhi; 29. Ibrahim Ali; 30. Mustafa, muhzir;⁸⁹ 31. Hasan, hallvaxhi; 32. Hasan, shyxha (trim); 33. Shaban, sofi (filozof, dervish); 34. Hysein, hajat (rrobaqepës); 35. Ali, hajat; 36. Musa, kasap; 37. Mustafa, kasap; 38. Memi, muhzir; 39. Ahmed, kazaz; 40. Ali, kasap; 41. Jusuf, nalband; 42. Osman, kasap; 43. Memi, kasap; 44. Ibrahim, kasap; 45. Mustafa, dellak; 46. Xhafër, arabaxhi; 47. Hasan, kasap; 48. Isa, kasap; 49. Hysein Abdullah (i islamizuar); 50. Oruxh Abdullah (i islamizuar). Gjithsej: 50 shtëpi (familje); të gjitha myslimane. Kjo mehallë është quajtur kështu nga kisha e dikurshme Levisha, kishë kjo, e cila ishte ngritur në kohën e sundimit ras, por nga një bazilikë bizantine. Meqë bizantinasi ishin, kryesisht, ilirë dhe grekë, atëherë, kultura bizantine ishte kulturë iliro-greke. Ndërkaq, duke qenë se të gjithë banorët e kësaj mehalle kishin përqufuar përnjëherë fenë islame ky fakt tregon se banorët e lagjes Lëvisha paskanë qenë ortodoksë shqiptarë.

3 *Mehalla e Ajas beut* kishte 15 shtëpi. Kryefamiljarët kishin këto mjeshtëri: tabakë, kasapë, ipekçinj, subashë (polic mbikëqyrës), mytevelinj (administrator i vakëfeve), muratorë, hajat (rrobaqepës), gëzoftarë (kyrkçy=kürkcü), etj. Në atë mëhallë ishin këta kryefamiljarë: 1. Hysein, hajat (rrobaqepës); 2. Ali, gëzoftarë (kürkcü); 3. Hysein, hajat; 4. Safer, hajat; 5. Jusuf, debak (tabak) (lëkur regjës); 6. Isa, kasap; 7. Hasan, ipekxhi (mëndafshhtar); 8. Mustafa, subash; 9. Memi Mustafa; 10. Mahmud, myteveli; 11. Sinan, hajat; 12. Mustafa, dylgër (murator); 13. Hasan, ipekxhi; 14. Hasan, gëzoftar; 15. Iskender Abdullah (i islamizuar); Gjithsej: 15 shtëpi myslimane.

4. *Mëhalla haxhi Kasimit* kishte 48 shtëpi, të gjitha të besimit mysliman. Kryefamiljarët zotëronin këto mjeshtëri: berberë, sapunxhinj, sagrëxhinj,⁹⁰ arabaxhinj, mutafxhinj,⁹¹ këpucëtarë, zhgunaxhinj (kebegir), xhezvexhinj, mullisë, dervishë, papuçinj, furtarë, tregtarë, ipekçinj (mëndafshxhinj), çizmexhinj, muratorë, drynarë, etj. Kjo mëhallë kishte këta kryefamiljarë: 1. Ali Gjoci; 2. Hysein Nuhu; 3. Hasan Gjini; 4. Osman, berber; 5. Musa, sapunxhi; 6. Hysein Barda; 7. Mustafa, sagrëxhi; 8. Mustafa, arabaxhi; 9. Rizvan Abdullah (i islamizuar); 10. Dervish, mutafxhi; 11. Mustafa, myteveli; 12. Mustafa, mutafxhi; 13. Hysein, shustër (këpucëtar); 14. Ibrahim, zhgunaxhi (kebegir); 15. Ali Deda, xhezvexhi; 16. Hysein, shustër; 17. Ali, mullis; 18. Memi, hajat (rrobaqepës); 19. Latif, arabaxhi; 20. Hysein, mutafxhi; 21. Muslih-el-din, dervish; 22. Shaban Abdullah (i islamizuar); 23. Ali, shuster; 24. Ramazan, mutaf; 25. Hasan,

⁸⁹ *Muhzir* (muhzër): nëpunës i gjyqit të sheriatit, i cili dokumentet i sjell në gjyq dhe i fton të paditurit; korjer.

⁹⁰ *Sagrëxhi* (turq. *sagrici*): lëkurëpunues nga pjesa e prampe e kalit.

⁹¹ *Mutafxhi* (turq. *mutafci*): endës i prodhimeve nga leshi i dhisë.

halife;⁹² 26. Memi, shuster; 27. Memi, merdâne (këpucëtar meshkujsh); 28. Hysein, shuster; 29. Mustafa, pashmakçi (pandofëlçi); 30. Ahmet, shuster; 31. Osman, shuster; 32. Memi, mutaf; 33. Hasan, hajat; 34. Osman, hajat; 35. Osman, shuster; 36. Ali, habbas; 37. Mustafa tregtar; 38. Rexhep, mutaf; 39. Hasan, berber; 40. Hajdar, ipekxhi; 41. Hysein, ipekxhi; 42. Memi, mutaf; 43. Sinan Ali; 44. Mustafa, çizmexhi; 45. Mustafa, dylger (murator); 46. Hamza, çilingir (drynar); 47. Pir, çizmexhi; 48. Musa, mutaf. Gjithsej: 48 shtëpi (familje) të besimit islam.

5) *Mëhalla e shkruesit (yazici) Sinan, ose e Emin Mehmedit* kishte 68 shtëpi myslimane. Kryefamiljarët kishin mjështëritë: këpucëtarë, arabaxhinj, farkëtarë, mutafxhinj, këpucëtarë, pashmakxhinj (pandofëlxi), tabakë kasapë, ipekçinj, sarëkinj, kazazë, ashçigjinj (gjellëtarë), çizmexhinj, kujunxhinj (argjendar), zhgunaxhinj, muratorë, malbandë, tregtarë, etj. Në këtë mëhallë ishin këta kryefamiljarë: 1. Ali, shuster; 2. Hasan Bardi; 3. Ali, arabaxhi; 4. Hysein, protoger (korjer); 5. Ahmed Diku; 6. Ali, kovaç; 7. Sylejman, arabaxhi; 8. Ali, arabaxhi; 9. Hasan, mutaf; 10. Ibrahim, shuster; 11. Sefer, shuster; 12. Hysein Karadaku; 13. Hasan, hajat; 14. Iljas, pashmakxhi; 15. Mustafa, tabak; 16. Ali papuçxhi; 17. Hysein, hajat; 18. Hasan, pashmakxhi; 19. haxhi Ahmet; 20. Ali, kasap; 21. Hysein, tabak; 22. Ahmet, ipekxhi; 23. Ali, sarëkçi; 24. Memi, hajat; 25. Ali, shuster; 26. Mahmut Bali; 27. Ibrahim, kasap; 28. Ahmet, hajat; 29. Ali, tabak; 30. Hasan, tabak; 31. Bali, mutaf; 32. Mehmet, kazaz; 33. Musa, hajat; 34. Ibrahim, kasap; 35. Iljaz, ashçi; 36. Mustafa, piri (sheh); 37. Murat, çizmexhi; 38. Ali, halife; 39. Ali, ashxhi; 40. Hysein, mutaf; 41. Ali, arabaxhi; 42. haxhi Mustafa; 43. Hysein, tabak; 44. Ahmet, kujunxhi; 45. Ali, çizmexhi; 46. Ali, mutaf; 47. Omer, mutaf; 48. Hysein, mutaf; 49. Kurd, mutaf; 50. Bali, mutaf; 51. Hysein, mutaf; 52. haxhi Mustafa; 53. Mustafa, kebegir (zhgunaxhi); 54. Ahmet, dylger (murator); 55. Hasan, mutaf; 56. Hamza, mutaf; 57. Dervish, mutaf; 58. Omer, nalband; 59. Hysein, karvanxhi; 60. Hëzër, tregtar; 61. Ferhad Reçi; 62. Sefer, mutaf; 63. Hasan, tabak; 64. Nasuh Ali; 65. Behram, arabaxhi; 66. Ali, arabaxhi; 67. Ahmet, sarëkçi, 68. Oruxh, mutaf. Gjithsej: 68 shtëpi myslimane.

6. *Mëhalla e çarshisë, apo e Jakub beut* kishte 18 shtëpi. Kryefamiljarët kishin këto mjështëri: hatibë, imamë, myezinë, sapunxhinj, kazazë, furrtarë, hallvaxhinj, këpucëtarë, berberë, dijetarë, qiripunues (mumcu), pashmakxhinj, kasapë etj. Ata ishin: 1. Mehmed, hatib; 2. Ahmet, imam; 3. Davud, myezin; 4. Mehmed, i panjohur; 5. haxhi Aves; 6. Hasan sapunxhi; 7. Mustafa, kazaz; 8. Mustafa, hajat; 9. Memi, habbas; 10. Mustafa, hallvaxhi; 11. Ibrahim, shuster; 12. Fethi, berber; 13. Bojaxhi, sofi; 14. Isa, mumxhu (qiripu-

⁹² *Halife*: zëvendës; zëvendës i Muhamedit; padishah; zëvendës i shefit (udhëheqësit) të një zyreje; kallf, mjështër i dytë.

nues); 15. Habil, pashmakxhi; 16. Musa, kazaz; 17. Mehmed çelebi (princ); 18. Isa, kasap. Gjithsej: 18 shtëpi (familje) myslimane.

7. *Mëhala e Gavrillit* kishte vetëm 31 shtëpi myslimane. Për kah zeja kryefamiljarët ishin: arabaxhinj, portjerë, ipekçinj, muratorë, katibë, mutafxhinj, drynarë, qeleshexhinj, rojtës, tregtarë, ashçinj, bojaxhinj, nalbandë. Kjo mëhallë kishte këta kryefamiljarë: 1. Hydaverdi, borazan; 2. Hasan, arabaxhi; 3. Dervish, borazan; 4. Hasan Basha; 5. Mustafa Hëzër; 6. Ahmet, kapuxhu (tur. kapucu=rojtari, portjer); 7. Ishak Gjijvan; 8. Hysein, ipekxhi; 9. Hysein, dylger (muratori); 10. Hysein, hajat; 11. Fazli, katib; 12. Ibrahim, hajat; 13. Ahmet, hajat; 14. Mahmut, mutaf; 15. Jolxhu, i varfer; 16. Hasan, opon; 17. Ali, arabaxhi; 18. Mustafa Hasan; 19. Ali, çilingir, (drynar); 20. Murteza, çilingir; 21. Ahmet, çilingir; 22. Ahmet, ipekxhi; 23. Isa, takijexhi (çeleshexhi); 24. Dërvish, hajat; 25. Hysein, çilingir; 26. Mehmet, dideban (rojtari); 27. Ahmet, muhzir; 28. Nasuh, tregtar; 29. Ali, ashxhi; 30. Ali, bojaxhi; 31. Mahmut, nalband. Gjithsej: 31 shtëpi (familje) myslimane.

8) *Mëhalla e tabakëve* kishte 33 shtëpi. Kryefamiljarët kishin këto mjeshtëri: tabakë, sapunxhinj, telallë, hamamxhinj, kazazë, lugëpunues, bojaxhinj, dellakë, këpucëtarë, çerçinj.⁹³ Mëhalla kishte këta kryefamiljarë: 1. Mehmet, hajat; 2. Jusuf, sapunxhi; 3. Oruxh, tabak; 4. Abdullah, telali; 5. Habil, hamamxhi; 6. Iljas Gaçja; 7. haxhi Mustafa; 8. Mehmet, kazaz; 9. Jusuf, kepçexhi;⁹⁴ Mustafa, bojaxhi; 11. Ala-el-din, tabak; 12. baba (sheh) Sa'di, tabak; 13. Hysein Ali; 14. Hysein, kepçexhi (lugëpunues); 15. Musa, tabak; 16. Osman, tabak; 17. Ahmet, shuster; 18. Memi, çirçi; 19. Behram, tabak; 20. Jusuf Abdullah; 21. Ibrahim, tabak; 22. Ali, tabak; 23. Jusuf, tabak; 24. Ahmet, hajat; 25. Ahmet, tabak; 26. Hasan, tabak; 27. Ibrahim, arabaxhi; 28. Ali, arabaxhi; 29. Mahmut, arabaxhi; 30. Hysref, tabak; 31. Memi, kebexhi (qebexhi=tur. kebeci); 32. Mehmet Abdullah (i islamizuar); 33. Ali Danko, tabak. Gjithsej: 33 shtëpi (familje) myslimane.

Të krishterët, zakonisht, i kishin mëhallët e veta të veçanta. Mëhallë të veçanta ishin këto:

1) *Mëhalla e pazarit të vjetër (Eski bazar)* kishte 8 shtëpi. Secila shtëpi kishte kryefamiljar burrim (hane) dhe kishte: 6 bashtina,⁹⁵

⁹³ Çerçi: cikrimtar; shitës i gjërave të imta.

⁹⁴ Kepçexhi (kepçeci): lugëpunues, garuzhdëpunues.

⁹⁵ Bashtinë (turq. başstine): zotërimi i tokës së krishterëve. Ajo trashëgohej nga i biri ose nga të bijtë. Bashtinarët meqë kryenin punë të ndryshme në të mirë të Oborrit të sulltanit dhe të ushtrisë ishin të liruar nga taksat e ndryshme. Bashtinë ishte toka ose arat që mbilleshin me kultura bujqësore. Ndërkaq, mulliri, vreshta, bahçet dhe shtëpitë nuk ishin bashtinë. Mirëpo, në Kosovë, disa të krishterë të islamizuar, i ruajnë bashtinat e veta, ani pse, bashtina ishte karakteristikë e pronave të të krishterëve.

2 beqar dhe 1 bazhdar (tagrambledhës). Kryefamiljarët e kësaj mëhallsë ishin: 1. Vaso, ardhacak (prishlac), 2. Stojko, ardhacak; 3. Dimitri Mihailo; 4. Mihailo, „mücerret“;⁹⁶ 5. Jovan Mihailo; 6. Mihailo Dimitri, „mücerret“; 7. Stepan Nikolla; 8. Mlladen, ardhacak. Bash-tinat ishin këto: 1. Bashtina e Ivanit, e cila gjendej në zotërim të Budakut, tani zotërohet nga Smaku; 2. Bashtina e Jankos, e cila gjendej në zotërim të Novakut, kurse tashti zotërohet nga banorët e mëhallës; 3. Bashtina e Bojas gjendet në zotërim të Gjonit; 4. Bashtina e Maticit gjendet në zotërim të Mano Grkut; 5. Bashtina e Dimitrit ndodhej në zotërim të Jovanit; 6. Bashtina e Markos zotërohej nga Pejo Dedja.

Beqarët e Prizrenit ishin: Stojan Dimitri dhe Mojse Veljani. Ndërkaq, Ilia, dhëndëri i Stepanit, ishte bazhdar me berat (dekret).

Siç po shihet, disa nga këta të krishterë, i kanë emrat karakteristike sllavë kurse disa prej tyre i kanë karakteristikë shqiptarë si dhe sufiksin e shqipes „i“, ose „a“.

2) *Mëhalla Mavriq ose zotëri (princ) Simos* kishte 37 shtëpi (familje) me kryefamiljar burrin (hane), 5 shtëpi me kryefamiljar „mücerret“ dhe 2 bazhnar. Kjo mëhallë kishte këta kryefamiljarë: 1. Nedelko, kallogjer (murg); 2. Pjetri Pejo; 3. Gardin Jovani; 4. Smir Kokojça; 5. Toma Dane; 6. Dimitri Sihoça; 7. Bjelosav Pejo; 8. Nikolla, pop; 9. Jaku Toma; 10. Smir Radko; 11. Stepan, ardhacak; 12. Gjuro Kraga; 13. Velan Nikolla; 14. Dimitri Simoni; 15. Mihailo Gjuroviq; 16. Todor Jovani; 17. Peça Davidi; 18. Mihailo Nedelko; 19. Jovan Dimitri; 20. Jovan Nikolla; 21. Dane, ardhacak; 22. Stanislav, ardhacak; 23. Jovan Zhojiq; 24. Llazar, ardhacak; 25. pop Cvetko; 26. Grulo, pop; 27. Rajo, ardhacak; 28. Cvetko Jaku; 29. Jovan Ivani; 30. Gjurgja, ardhacak; 31. Nikola, gëzoftar (kürkci); 32. Jovan Makriq; 33. Nikola Milo; 34. Pjetri Simoni; 35. Stepan Dimitri; 36. Bezhan Jovani; 37. Bogdan Jovani. Familjet „mücerret“ ishin: 1. Jovan Bogdani; 2. Stojan Makriq; 3. Svetko Milo; 4. Milo Stojan; 5. Jovan Gruja. Ndërkaq bazhdarë ishin: 1. Gjuro Kalia dhe 2. Pjetri, dhëndri i Jovanit, bazhdar me berat.

Nga të dhënat e sipërme mund të konkludohet se në këtë mëhallë kishte mjaft ardhacakë, d.m.th. fshatarë të vendosur në qytet, të cilët janë pranuar si sheherlinj (qytetarë), si dhe një numër i konsiderueshëm sish mbajnë emrat karakteristikë të shqipës së asaj kohe.

3) *Mëhalla Vasil* kishte 26 shtëpi (familje) me kryefamiljar „burrin“ (hane) dhe 4 shtëpi „mücerret“ (beqar). Kryefamiljarë ishin këta persona: 1. Manojlo Nikolla; 2. Ilija Nikolla; 3. Gjuro Jovani; 4. Kojo Gjurko; 5. pop Moisi; 6. Gaverin Jovani; 7. Mlladen, ardhacak; 8. prokop, kujunxhi; 9. Jovan Llazari; 10. Pjetrash Nikolla; 11. Pjetri Nikolla; 12. Pjetri Dimitra; 13. Cvetko Stepani nga fshati

⁹⁶ *Mücerret*: familje (shtëpi) me kryefamiljar beqarin.

Zagradina Hoça; 14. Jovan Nikolla; 15. Smir Jovani; 16. Pejo Ajalja; 17. Smir Kuka (Koka); 18. Iftina, pop; 19. Manojlo, pop; 20. Bajo, terzi; 21. Jovan, kujunxhi; 22. Nikolla Pjetri; 23. Stojko Grujo; 24. Nikolla Pjetrash; 25. Jovan Ivani; 26. Nikolla, ardhacak. Ndërsa familjet „mücerret” ishin: 1. Gjuro, pop; 2. Jovan Stojko; 3. Ivan Jovani; 4. Bojor (?) Jovani. Gjithsej: 26+4 shtëpi (familje)=30. Edhe në këtë mëhallë, përveç emrave karakteristik sllavë, hasim edhe në emra shqiptarë të krishterë të asaj kohe, sidomos bie në sy sufiksi i shqipes.

4) *Mëhalla Gavra ose Gavrila* kishte 16 shtëpi (familje) nga të cilat: 12 shtëpi „hane”, 3 „mücerret” dhe 1 bazhdar. Kryefamiljarë ishin: 1. Iliash, ardhacak; 2. Jovan Puta; 3. Nisha Bushadi; 4. Jovan Koka; 5. Gjin Golemi; 6. Bogosav, ardhacak; 7. Peça, mullisë (değirmenci); 8. Doç Bushadi; 9. Dimitri Davidi; 10. Lika Koka; 11. Koia Ulku; 12. Jovan, ardhacak. Familjet „mücerret” ishin: 1. Stepa Peça; 2. Jovan Paci; 3. Prend Puta. Kurse bazhdar me berat ishte: Miço Stojko. Gjykuar sipas emrave, pothuajse, të gjithë ishin shqiptarë.

5) *Mëhalla çarshia ose Pjetri Nikolla* kishte vetëm 14 shtëpi me kryefamiljar burrin. Ndër kryefamiljarët njëri ishte pop. Shtëpitë kishin këta kryefamiljarë: 1. Ginajlo, pop; 2. Stepan Ginajlo; 3. David Pavli; 4. Jovan Vuka; 5. Jovan Jovani; 6. Jovan Dimitri; 7. Smir Dimitri; 8. Bojor Kojçini;⁹⁷ 9. Jovan Nikolla; 10. Goran Nikolla; 11. Vojo Gjuro; 12. Jovan Marloviq; 13. Cvetko Gjurini; 14. Pejo Cvetko. Pra, edhe banorët e kësaj mëhalle mbanin emra dhe mbiemra karakteristike shqiptarë dhe sllavë të kohës.

6) *Mëhalla Bogoi Ribar* kishte 11 shtëpi „hane”, 4 shtëpi „mücerret”, 2 bazhdarë dhe 4 kisha. Kanë qenë këta kryefamiljarë: 1. Toma Lukiç; Vojo, ardhacak; 3. Marko Jovani; 4. Pavl Radosavi; 5. Vuça, kujunxhi; 6. Nikola Stepani; 7. Vukashin Vasili; 8. Andreja, ardhacak; 9. Jovan, ardhacak; 10. pop Vojo, ardhacak; 11. pop katolik (latin). Shtëpitë „mücerret” ishin: 1. Ergina Vuça; 2. Piak (Pjak, Plak) Gjoni; 3. Koja Vojo; 4. Stepan Liku. Bazhdarë ishin: 1. Pacla Toma, bazhdar me berat; 2. Pjetri Stepani, bazhdar me berat. Ndërka, kishat ishin: I. Kisha e Vladkos; II. Kisha e re katolike (latine); III. Kisha e pop Stepanit; IV. Kisha e Nikollës. Me fjalë të tjera në këtë mëhallë kishte ortodoksë dhe katolikë, shqiptarë, sllavë dhe vllëh. Në të mirë të këtij vlerësimi flasin emrat e kryefamiljarëve të mëhallës.

7) *Mëhella Radomir* kishte 46 shtëpi „hane”, 6 „mücerret” dhe 5 bashtina: 1. Mlladen Nikolla; 2. Jovan Veljani; 3. Nikolla Bashko; 4. Jovan Stojko; 5. Simon Dimitri; 6. Jovan Marko; 7. Dule Jaku; 8. Dimitri Vllah; 9. Konstantin Karanxhi; 10. Smir Gjuko; 11. Cvetko

⁹⁷ Sot e kësaj dite në Kosovë ka familje shqiptare me mbiemër Kojçin.

Dimitri; 12. Pjetri Dimitri; 13. Jovani, tjetër, ardhacak; 14. Gjuro Vojko; 15. Milo Gërku; 16. Ivan Petro; 17. Romo Rada; 18. Jovan, ardhacak, tjetër; 19. Novak, ardhacak; 20. Brajak, kalugjer; 21. Pjetri Jovani; 22. Gjuro, ardhacak; 23. Jovan, pop; 24. Kozman Cvetko; 25. Mlladen Dimitri; 25. Svetko Pastroviq; 26. Pavlo, pop; 27. Lukiq, ardhacak; 28. Dimitri, ardhacak; 29. Marko Miloshi; 30. Jovan, ardhacak; 31. Dule Vijo; 32. Samjan, ardhacak; 33. Duko Karanxhi; 34. Jovan, ardhacak; 35. Cvetko, ardhacak; 36. Vuça Marko; 37. Bogdan Petro; 38. Nikolla Petro; 39. Grubo, ardhacak; 40. Todor, kovaç; 41. Kozma Prejak; 42. Simo Jovani; 43. Mihailo, pop; 44. Cvetko Gërku; 45. Pavl Cvetko; 46. Miço, kujunxhi. Shtëpitë „mücerret” ishin: 1. Manojlo Jovani; 2. Smir Cvetko; 3. Gjuro Dimitri; 4. Ginajlo Rada; 5. Gramo, pop; 6. Cvetko, ardhacak. Bashtinat, ndërkaq, ishin: I. Bashtina e Boganit në zotërim të Nikollës, ardhacak; II. Bashtina e Nikolla Gjuros në zotërim të Gjurkos; III. Bashtina e Didës në zotërim të Petros; IV. Bashtina e Pejës në zotërim të Jovës; V. Bashtina e Dimitrit në zotërim të Pejës, tani në zotërim të banorëve të mëhallës. Duke pasur parasysh karakteristikat e emrave të kryefamiljarëve mund të konkludohet se banorët e kësaj mëhale, në pikëpamje etnike, ishin: shqiptarë, sllavë dhe vllëh.

8) *Mëhalla e shkruetit (vazici) Sinan, ose i emin Mehmedit* kishte 24 shtëpi „hane” dhe 9 shtëpi „mücerret”. Kryefamiljarë janë: 1. Dejan, gëzoftar (korkçü); 2. Raxha, ipekxhi; 3. Andreja, ardhacak nga nahija e Pjetër Shpanit; 4. Novak Marku; 5. Doda Papa; 6. Jovan Andrija; 7. Pjetri Rada; 8. Lusha, shuster; 9. Nika Ulkash; 10. Pepa Maxheri; 11. Pjetri Pepa;⁹⁸ 12. Gjika Pepa; 13. Koka, papuçxhi; 14. Pepa Doçi; 15. Stepa Pejo; 16. Vuka, shuster; 17. Pejan, papuçxhi; 18. Vojo, gëzoftar; 19. Stojko, ardhacak nga fshati Denica; 20. Ulkash Boshko; 21. Popa Pepa; 22. Peç Laçi; 23. Gika, papuçxhi; 24. Gjon Doçi. Shtëpitë „mücerret” ishin: 1. Deja Gika; 2. Mark Jovani; 3. Kola Andrija; 4. Jovan Pjetri; 5. Pjetri Ulkash; VI. Bozhiq Pjetri; VII. Bajca Gika; VIII. Marko Pejo; IX. Ulkash, shuster. Edhe në këtë mëhallë mbizotërojnë emrat shqiptarë, karakteristikë të kohës. Mirëpo, është me interes të vihet në pah dhe një fakt. Emri i kësaj mëhale është identik me emrin e një mëhale myslimane. Kjo, mendoj, tregon se fjala është për një mëhallë të madhe. Meqë, pjesa më e madhe e banorëve të kësaj mëhale e kishte përqafuar fenë islame dhe mbajnë edhe emra myslimanë, ndonëse një numër familjesh (29+9=33) kishin mbetur ende në fenë krishtere.

9) *Mëhalla Patolja* kishte 31 shtëpi. Prej tyre ishin 28 „hane” dhe 3 „mücerret.” Kanë qenë këta kryefamiljarë: 1. Manojlo Stepa; 2. Simon, ardhacak; 3. Gjuro Deja; 4. Bozan, ardhacak; 5. Deja, ardhacak; 6. Pal Baci; 7. Gjika Deja; 8. Stepa Kola; 9. Tusha, nga na-

⁹⁸ Në Pejë sot e kësaj dite ka shqiptarë të besimit mysliman që mbajnë mbiemrin P e p a.

hija e Pjetër Shpanit; 10. Bogdan Doçi;⁹⁹ 11. Jovan Kola; 12. Mihailo Pejani; 13. Pal Stepa; 13. Pal Deda; 15. Iliash Svetko; 16. Pavla Radko; 17. Jovan Kola; 18. Stepa Doçi; 19. Pepa Kola; 20. Pal Kola; 21. Jovan Lala; 22. Jovan Gjika; 23. Andreja, ardhacak; 24. Andre Gjika; 25. Jovan Stepa; 26. Pal Bozhiqi; 27. Prend Deda; 28. Doda¹⁰⁰ Doçi. Shtëpitë „mücerret” ishin: 1. Pepa Doçi; 2. Jovan Simoni; 3. Andreja Pepa. Emrat e këtyre banorëve, siç po shihet, janë karakteristik me emrat e shqiptarëve të krishterë të kohës.

10) *Mëhala Prend Vërdica* kishte 10 shtëpi, nga të cilat 9 „hane” dhe 1 „mücerret”. Në këtë mëhallë ishte edhe një kishë. Kryefamiljarët 1. Pejo Smiri; 2. Komnin Beçajini; 3. Grubo, ardhacak; 4. Gjurko, ardhacak; 5. Dimitri, ardhacak; 7. Toma Smiri; 8. Lukiç, ardhacak; 9. Mile Gjurko; 9. Dimitri Nikolla. Shtëpi, „mücerret” ishte ajo e Lala Grubos.

11) *Mëhalla Iljas ose Azkuçan*¹⁰¹ kishte 14 shtëpi, ndër to 13 „hane” dhe 1 „mücerret.” Ato kishin këta kryefamiljarë: 1. Pjetri Kola; 2. Dimitri Kola; 3. Doda Gjika; 4. Jovan Doçi; 5. Petra Dida;¹⁰² 6. Prend, ardhacak; 7. Andrija Kola; 8. Stepa Kola; 9. Jovan Doda; 10. Pjetri Lika; 11. Jovan Pejo; 12. Jovan Petra; 13. Vojo Nikolla. Nga shtëpitë, „mücerret” përmenden ajo e Mlladen Jovanit. Të gjitha këto emërtime janë karakteristike me ato shqiptare të kohës.

Në defterin e cekur sipër janë regjistruar edhe gjashtë veta të cilët ishin vendosur me çadra (hayme-gâh) në Mëhallën Patolja. Ata ishin: 1. Pjetri Vojo; 2. Dobrosav, ardhacak; 3. Todori, terzi; 4. Pejo Grujiq; 5. Lukiç; 6. Dimo, terzi.

Pra, Prizreni më 1590/91 kishte 8 mëhallë të mëdha myslimane dhe 11 mëhallë të vogla krishtere, në të cilat gjendeshin 316 shtëpi myslimane dhe 284 shtëpi krishtere, prej të cilave ishin: 229 shtëpi „hane”, 38 shtëpi „mücerret”, 11 bashtina dhe 6 bazhdarë. Në Prizren, në këtë kohë ishin edhe 4 kisha ortodokse dhe katolike. Po ashtu ekzistonin 4 frymë që banonin në çadra (hayme-gâh). Me fjalë të tjera qysh në gjysmën e dytë të shekullit XVI në këtë qytet mbizotëronte elementi islam.

Të ardhurat e përgjithshme të myslimanëve të vetë (nefsi) Prizrenit kapnin 6.380 akçe. Kurse të ardhurat e të krishterëve kapnin 44.520 akçe. Gjithsej: 50.900 akçe.¹⁰³

Prizreni, ndërkaq, kur u vizitua nga Marin Bici (1610), vetëm qyteti kishte 8.600 shtëpi shumë të mëdha që pothuajse të gjitha i

⁹⁹ Emri Doçi si mbiemër është i shpeshtë tek shqiptarët e Gegërisë.

¹⁰⁰ Sot e kësaj dite ka familje me mbiemër Doda në Prizren. Këto janë familje shqiptare të besimit mysliman.

¹⁰¹ *Azkuçan* ndoshta do të thotë Az-kuçan (turqisht-serbisht) „pak-shtëpi”.

¹⁰² Në Prizren edhe sot ekzistojnë familjet shqiptare të besimit mysliman me mbiemër Dida.

¹⁰³ Tapu ve Kadastro (Umum) Müdürlüğü, Ankara *Defter-i Mufassal-i Livâ-i Prizren*, Sene 999. Sîtra 412, Yeni Numara 55.

kishin oborret e veta si shtëpitë fshatare në Itali. Toka e punueshme e tij ujitej gjithkund nga krojet dhe nga lumenjtë, të cilët ishin pasuri e pazëvendësueshme e qytetit. Në qytet tingëllonte herë pas here një kumonë, e cila ishte e vendosur përmbi njëren nga minaret e shumta të xhamive dhe punonte një orë e madhe, të cilën disa francezë ua kishin ndërtuar turqve (myslimanëve — S.R.), punë e jashtëzakonshme në Turqi. Aty kishte më shumë se 30 shtëpi latinësh me kishën që mbante titullin e Zonjës së Ngjitur në Qiell. Kishte shumë skizmatikë në qytet, të cilët i kalonin shumë latinët dhe kishin vetëm 2 kisha nga 80 që kishin më parë.¹⁰⁴

Disa vite më vonë Pjetër Mazreku shkruan (1623/24): „Prizreni ka 12.000 frymë turq (myslimanë — S.R.), pothuajse të gjithë shqiptarë, të shkathët prej natyre dhe të aftë për çdo ndërmarrje. Katolikë, po prej këtij kombi, mund të jenë rreth 200 frymë, dhe janë të varfër nga shkak i avanive (keqpërdorimeve); ata kanë vetëm një kishë, të ndërtuar prej të parëve të tyre e cila, megjithëse ishte e pajisur me veshje të pasura, tridhjetë vjet më parë, pësoi, nga një zjarr dhe humbi çdo gjë të bukur e të mirë që kishte (...) Aty ka nja 600 frymë serbë”.¹⁰⁵

I njëjti relator, Pjetër Mazreku, në relacionin e tij të vitit 1633, për Prizrenin shkruan kështu: „Qyteti më fisnik i kësaj krahine duket se ka qenë Prizreni (...) Ka një ajër shumë të këndshëm, por, meqenëse nuk është në rrugën kryesore, as në shteg me rëndësi, është i rrahur pak. Është i pasur me ujëra shumë të shëndoshë, me ajër të mirë e me vreshta të shkëlqyeshme, por i mungojnë pasuritë; i vijnë në ndihmë veçse një shumicë mullinjsh të vendosur mbi një lum që i kalon për mes. Thonë se ky është atdheu i perandorit Justinian”.¹⁰⁶ E, siç dihet, Justiniani ishte perandor i Perandorisë Bizantine në kohën kur ajo arriti zhvillimin më të madh të saj, d.m.th. në shekullin VI, kur edhe e ndërtoi kishën e njohur Shën-Sofinë (sot xhami-muse me emrin „Aja Sofia”) në Konstantinopojë-Istambull. Justiniani ishte me origjinë ilirë.

Prizreni, siç na informon Gjergj Bardhi (1637), me fshatrat përreth, mund të kishte 540 frymë (katolikësh — S. R.).¹⁰⁷ Ndërsa në relacionin tjetër të vitit 1638 Gjergj Bardhi shkruan: „Në varosh kishte 22 shtëpi të krishtera, me 325 frymë. Ky qytet kishte edhe 34 shtëpi me popullsi ortodokse. Pos këtyre, në Prizren (Prisren) ishte vendosur edhe një pjesë e popullsisë shqiptare (6 shfëpi me 20 frymë), që kishte ardhur prej Pulti. Shtëpi të turqve (myslimanëve — S. R.) mund të kenë qenë rreth trimijë (...). Kështjellen e ka

¹⁰⁴ Injac Zamputi, *Relacione*, I, fq. 169, 170, 171.

¹⁰⁵ *Po aty*, fq. 337. Pjetër Mazreku, siç po shihet, të gjithë pjesëtarët e kishës ortodokse (serbët, shqiptarët dhe vllahët) i konsideron për serbë. Qysh atëherë pra kishte filluar diferencimi kombëtar sipas fesë. Zaten, sipas Pjetër Mazrekut shqiptarët e islamizuar ishin turq në pikëpamje fetare, kurse në pikëpamje kombëtare shqiptarë. Ndërkaq, shqiptarët katolikë ishin, po ashtu, në pikëpamje kombëtare, shqiptarë.

¹⁰⁶ *Po aty*, fq. 431.

¹⁰⁷ Injac Zamputi, *Relacione*, II, fq. 97.

mbi kodrinën e një mali të lartë, gjysëm mile larg nga varoshi; pak njerëz në kështjellë”.

Prandaj, në qoftë se i marrim parasysh të dhënat e Gjergj Bardhit të vitit 1638, atëherë mund të konkludojmë se në Prizren kishte, aso kohe, 22 shtëpi katolike me 325 frymë, d.m.th. mesatarisht afro 15 frymë për shtëpi; 34 shtëpi skizmatikësh (ortodoksë) me 510 frymë (serbë, shqiptarë, vllah); 3.000 shtëpi turq (myslimanë: shqiptarë, një pakicë turq) me afro 45.000 frymë. Pra, Prizreni kishte një 45.835 banorë. Më fjalë të tjera në Prizren, në shtatëdhjetëvjetshin e shekullit XVII, mbizotëronte përgjithsisht elementi shqiptar.

Nga ana tjetër, gjatë vjetve 1641—42 Gjergj Bardhi, ndër të tjerash, nënvizoi: „Shtëpi katolikësh në vendin e thënë janë 40. Frymë të krishtera, nga njera dhe tjetra gjini, mund të janë 400. Frymë të krezmuar (pren nesh) 40. Në këtë vend gjenden 80 shtëpi skizmatikësh. Si jemi informuar nga pleqë, shtëpi të turqve (myslimanëve — S. R.) ka rreth 3.000 dhe (Prizreni) nuk është qytet por varosh,¹⁰⁸ dhe përmes të këtij vendi kalon një përrua i quajtur Bushtrica (. . .).¹⁰⁹

Domethënë në vitin 1641/42 Prizreni kishte:

Shtëpi katolike (shqiptarë)	40
Shtëpi skizmatikësh (serbë, shqiptarë, vllah)	80
Shtëpi turqish (myslimanë: shqiptarë, turq)	3.000

Gjithsej: 3.120 shtëpi

Nëse merret mesatarja 15 frymë në një shtëpi, siç e kishte marrë këtë mesatare Gjergj Bardhi në vitin 1638, atëherë në Prizren në vitin 1641/42 kishte 46.800 frymë. Ndërkaq, nëse merret mesatarja 10 frymë për një shtëpi, atëherë në Prizren kishte afro 31.200 frymë. Sidoqoftë, Prizreni ishte qytet i madh dhe i zhvilluar në çdo pikëpamje në mesin e shekullit XVII.

„Tregtia e Prizrenit zakonisht bahet me verë dhe lëkura. Nga lumi i quajtur Bistrica, që i rrjedhë për mes, ushqehet me trofta e lloje të tjera peshqish. Ka njerëz të armatosun meqë pikërisht aty punohen pushkët të çdo lloji damaskine shumë të persosuna”, thotë Pjetër Bogdani (1685).¹¹⁰

Sipas të dhënave që jep Coronelli në „Illiricum” — 1688 dhe në „Corso delli fiumi Drino e Boiana nela Dalmatia” — 1689 në Prizren kishte 6.000 shtëpi.¹¹¹ Në këtë mënyrë, pra, nëse llogaritet

¹⁰⁸ Termat *kështjellë*, *qytet* dhe *varosh* (castello, città, borgo) kanë këto kuptime: *qytet* mesjetar ishte vendbanimi i rrethuar me mure dhe brenda këtij vendbanimi ishte një qendër e fortifikuar, ose *kështjellë*; kurse *varoshi* u formua jashtë mureve rrethuese të qytetit dhe përmbante lagjet periferike të tija.

¹⁰⁹ Injac Zamputi, *Relacione*, II, fq. 107.

¹¹⁰ *Burime të zgjedhura*, Tiranë, 1962, fq. 153.

¹¹¹ Muharrem Cërabregu, *Kosova në hartat e vjetra*. UP, Prishtinë, 1977, fq. 92.

se një shtëpi kishte mesatarisht 10 frymë, siç llogaritnin relatorët e kohës, atëherë Prizreni kishte 60.000 frymë më 1688/89. Sidoqoftë, edhe nëse ka pasur jo më shumë se 40.000 frymë, ky numër, për atë kohë, ishte numer kolosal. Mirëpo, edhe Prizreni, sikurse edhe qytetet e tjera të Kosovës, për shkak të luftës turko-austriake (1689/90) dhe të epidemisë së murtajës, në fund të shekullit XVII mori goditje të ndieshme.

Ndonëse, në fund të shekullit XVII edhe Prizreni ra ekonomikisht dhe në pikëpamje të numrit të banorëve, ai, duke filluar nga shekulli XVIII ngritet, vërtet ngadalë, por me hapa të sigurt, ashtu që në dekadën e katërt të shekullit XIX bëhet përsëri qyteti më i rëndësishëm në gjithë Kosovën.

Lidhur me zhvillimin e Prizrenit gjatë shekullit XVIII dhe në dekadat e para të shekullit XIX, kemi shënime të shumta. Kështu, në qershor të vitit 1749 përmendet tregtari mula Zejneli nga Prizreni, i cili dorëzon në Shkodër 90 dengje lesh.¹¹² Ndërsa, më 16 gusht 1749, një farë Tahiri i Mehmet Bajramit të Madh me shokun e vet Domënorin ia dorëzuan Xhiovani Paolo Ocionit në Shkodër nga Prizreni 28 dengje lesh dhe 2 dengje dyllë.¹¹³

Duke folur për Prizrenin argjipeshëvi Pjetër Karaxhiqi (Petar Karadžić), në mesin e shekullit XVIII, thotë se Prizreni është qytet shumë i bukur dhe ka një pozitë jashtëzakonisht të mirë. Aty ka godina dhe kisha të bukura.¹¹⁴ Në këtë kohë Prizreni furnizohej me vaj dhe me artikuj të tjerë nga Shkodra, qoftë me artikuj bregdetarë të Shqipërisë, qoftë me artikuj evropianë, që transportoheshin nëpërmjet të Shkodrës për në Prizren.¹¹⁵

Në Katastigun e manastirit të Deviçit Prizreni më 1766 përmendet si qytet, kurse në vitin 1773 si varosh. Pastaj, regjistruesi i këtij manastiri, në atë kohë, shënoi se në Prizren kishte shumë vllah (cincarë), të cilët merreshin me këto zeje: biqakçinj (briskaxhinj), dungjerë (muratorë), kujunxhinj (argjendarë, artarë), mumxhinj (qirinjmbaruesë), mutafxhinj, papuçxhinj, sapunxhinj, simitçinj, qurqinj, çanakçinj etj.¹¹⁶

Shiitizmi ishte përhapur mjaft edhe në qytetet e Kosovës. Këta ishin, pra, në krye të teqeve të kaderinjve — në Prizren, në Gjakovë, në Pejë, në Shkup, etj. Shehlerët e këtyre teqeve u mësonin tabakëve dhe njerëzve të tjerë diturinë mbi ligjin e shenjtë (sheriatin), mbi tarikatin, mbi sekretin e botëkuptimit të së vërtetës (hakikatin), kultivimin e dashurisë dhe zellin për zejen (ashkun e marife-

¹¹² Stavri N. Naçi, *Shqipëria e Veriut në shekullin XVIII* (Letra të zëv. konsujve venedikas të Shkodrës), Vëllimi I (1706—1756), Tiranë, 1967, fq. 284.

¹¹³ *Po aty*, fq. 289.

¹¹⁴ J. Radonić, *Rimska kurija u jugoslovenskim zemljama*, Beograd, 1950, fq. 647.

¹¹⁵ Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare*, Tiranë, 1973, fq. 312.

¹¹⁶ Gl. Elezović, *Rečnik kosovsko-metohijskog dijalekta*, sveska druga, Beograd, 1935, fq. 134.

tit).¹¹⁷ Në Prizren njihet edhe esnafi i tyxharëve (esnafi i tregtarëve — gilda tregtare).¹¹⁸ Me një fjalë Prizreni ekonomikisht ishte i lidhur, pothuajse, me të gjitha qytetet e Shqipërisë dhe të Ballkanit.¹¹⁹

Në vitin 1818 anipse Prizrenin e kishte kapluar epidemia, e cila gjithsesi e dërmoi, nga Prizreni mallrat e ndryshme, si bie fjala vaji, eksportohen për në Serbi të Milosh Obrenoviçi.¹²⁰ Ndërsa Vuk Karaxhiqi (Karadžić) më 1827 Prizrenin e quan qytet të vjetër me varosh të madh.¹²¹ Tregtarët e Prizrenit, në të vërtetë, në vitin 1828 eksportojnë mallra të lloj-llojshme në Serbi.¹²² Ndërkaq, sipas Ami Bues në Prizren, në kohën e tij (dekada e tretë e shekullit XIX), kishte 26.000 banorë.¹²³

Mirëpo, sipas regjistrimit të popullsisë së Perandorisë Osmane, më 1831, në gjithë Sanxhakun e Prizrenit (Kazaja e Prizrenit me Suharekën, kazaja e Bihorit, kazaja e Tërgovishtës — Rozhaja) kishte vetëm 30.416 banore, prej të cilëve 22.334 ishin me besim myslimanë (shqiptarë, turq) dhe 8.082 të krishterë (ortodoksë dhe katolikë) dhe jevgj. Vetëm në kaza të Prizrenit me Suharekën kishte 9.488 banorë myslimanë (shqiptarë, turq), 1.912 të krishterë-ortodoksë (serbë, vllah), 1.276 jevgj dhe 35 katolikë (shqiptarë).¹²⁴ Kjo do të thotë se numri i popullsisë, në fillim të dekadës së katërt të shekullit XIX, kishte rënë jashtëzakonisht shumë, në krahasim me gjendjen ekzistuese gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII (deri më 1689/1690), madje-madje duke marrë parasysh edhe shënimet e dhëna të Ami Bues (nga dekada e tretë e shekullit XIX). Si duket, kjo katastrofë e rënies së popullsisë ishte shkaktuar, në radhë të parë, nga ndonjë epidemi, siç ishte ajo e murtajës, e cila edhe nga fillimi i shekullit XIX, kohë pas kohe bënte kërdi. Gjithsesi në rënien e popullsisë kanë ndikuar edhe luftërat e përgjithshme që u zhvilluan aso kohe (mu në vitin 1831) në mes të ajanëve shqiptarë, në krye me Mustafa pashë Bushatin, dhe të Perandorisë Osmane. Ajanët shqiptarë synonin të shkëputeshin nga Perandoria Osmane dhe të bëheshin të pavarur. Luftërat e përgjakshme janë zhvilluar, madje, edhe në truallin e Kosovës.

Në vitin 1834 në panairin e Pozheshkut, në Serbinë e Millosh Obrenoviçi, prizrenasi Gjorgje Angjelkoviçi (Gjorgje Anđelković) shiti brisqi, me ç'rast pagoi 15 groshë për qira të dyqanit dhe 9,30 groshë për taksë.¹²⁵ Kurse, prizrenasi Vasil Paskaviçi (Vasilj Pas-

¹¹⁷ Zija Shkodra, *vep. e cit.*, fq. 148.

¹¹⁸ *Po aty*, fq. 203.

¹¹⁹ *Po aty*, fq. 291.

¹²⁰ Danilo Vulović, *Knjaževska kancelarija*, Knj. I, Nahija Požeška, 1815—1839, Državni Arhiv NRS, Građa, Knj. III, Beograd, 1953, fq. 21.

¹²¹ Kosta N. Kostić, *vep. e cit.*, fq. 5.

¹²² Danilo Vulović, *vep. e cit.*, fq. 240.

¹²³ Ami Boué, *La Turquie d'Europe*, Tome deuxième, Paris, 1840; K. N. Kostić, *vep e cit.*

¹²⁴ E. Ziya Karal, *Osmanlı İmparatorluğunda İlk Nüfus Sayımı 1831*, T. C. Başvekalet İstatistik Umumü Müdürlüğü, Ankara, 1943, fq. 85, 86.

¹²⁵ Danilo Vulović, *vep. e cit.*, fq. 451.

kavić) në panairin e cekur shiti pushkë dhe pagoi 18 groshë për qira të dyqanit dhe 9,30 groshë për taksë.¹²⁶ Në të njëjtin panair shiti pushkë edhe prizrenasi Simo Mijatoviqi (Simo Mijatović). Për këtë arsye ai pagoi për qira të dyqanit 20 groshë, kurse për taksë 9,30 groshë.¹²⁷ Në panairin e Pozheshkut nxori prodhimet e veta edhe terziu i Prizrenit Pjetër Josifoviqi (Petar Josifović). Pramdaj, ai pagoi 25 groshë për qira të dyqanit dhe 9,30 groshë për taksë.¹²⁸

Për panoramën e Prizrenit më së miri na flet J. Müller (1838). Sipas këtij udhëpërshkruesi dhe bashkëkohësi Sanxhaku i Prizrenit kishte 80.000 banorë. Bota bimore e këtij vendi të rëndësishëm jepte drithëra e pemë, si dhe verëra të forta. Rrafshinat e gjera i mbulojnë tufa të panumërta buallicash. Qyteti i Prizrenit shtrihet në një luginë të valëzuar, të cilën e përshkojnë tri procka. Numri i banorëve kap 5.000 myslimanë (kryesisht shqiptarë — S. R.), 2.150 katolikë (shqiptarë — S. R.) dhe 18.000 grekë (ortodoksë-serbë dhe vllëh — S. R.). Numri i shtëpive arrin mbi 6.000, por ato janë fatkeqësisht përdhese dhe prej balte. Përrjashtim bën konaku (administrata) i shkëlqyeshëm, i cili gjendet në pjesën jugperëndimore të qytetit me kopshtin e rregulluar sipas shijës franceze. Kisha e bashkuar greke (ortodokse) e shën, Petkut është e mfshehur nën masën e shtëpive në pjesën juglindore të qytetit. Kisha katolike është e rrënuar dhe shërben si shesh për ekzekutimin e të denuarëve me vdekje. Numri i xhamive është 42 e më e bukura është e Emin pashës, e cila gjendet në hyrje të pazarit, e ndërtuar sipas shembullit të Sylejmanijes në Stamboll. Në pikëpamje historike më e rëndësishmja është xhamia e Ahmedit. Në qendër të qytetit ndodhet pazari që përbëhet prej 1.630 dyqanesh. Artikujt krvesorë janë: leshi, vera dhe pëlkurat e mëndafshta. Në anën e tij juglindore gjendet hani për 400 vetë. Drejtpërdrejt në të mbështetet kodra e lartë 185 hapa, majën e së cilës e kurorëzon kështjella, e cila para pak kohe është rregulluar që të mund të shfrytëzohet për banim dhe e cila shërben si kazermë.¹²⁹

Shënimet e dhëna nga J. Müller, shënime këto për popullsinë, më duket se, duhet marrë me një dozë rezerve, përsa i përket saktësisë së strukturës fetare-kombëtare të popullsisë. Sepse, sipas tij, në Prizren kishte:

Myslimanë (shqiptarë, e turq)	5.000 frymë
Katolikë (shqiptarë)	2.150 „
Grekë (ortodoksë: serbë dhe vllëh)	18.000 „

Gjithsej: 25.150 frymë

¹²⁶ *Po aty*, fq. 452.

¹²⁷ *Po aty*, fq. 453.

¹²⁸ *Po aty*.

¹²⁹ Bedrush Shehu, *Një raport i J. Müllerit për Kosovën në vitin 1838*, „Kosova” V. Prishtinë, 1976, fq. 72, 73.

Vërtet, popullsia dhe ekonomia e Prizrenit në shekullin XIX, në krahasim me atë që kishte pasur në shekujt XV, XVI dhe XVII, kur qyteti kishte një popullsi prej më se 40.000—50.000 banorë, ku mbizotëronte elementi myslimanë-shqiptarë, kishte rënë për së tepërmi. Banorët e tij janë pakësuar për dy-tri herë. Mirëpo, përpjesëtimi në mes të elementit mysliman dhe atij ortodoks, më duket, nuk është plotësisht në rregull. Zaten, sipas Sallnamës (Vjetarit) të Vilajetit të Kosovës për vitin 1314 H. (1896/7), në Prizren, në atë kohë ishte kjo strukturë e popullsisë:

Muslimanë	7.263 frymë
Ortodoksë	2.035 frymë
Katolikë	389 frymë
Jevgj	489 frymë
Gjithsej: 10.176 frymë ¹³⁰	

¹³⁰ *Kosova Vilâyeti Sâlnamesi*, 1314 H., fq. 514, 515.

هذه هي الحروف التي
يكتب بها اللغة
العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية
العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية



































العثمانية

العثمانية

العثمانية

العثمانية

Handwritten text in Albanian script, organized into two columns. The right column contains approximately 15 lines of text, and the left column contains approximately 15 lines. The script is a cursive form of the Latin-based Albanian alphabet. There are several horizontal lines and some larger, more complex markings interspersed within the text, possibly serving as section dividers or decorative elements. The text appears to be a historical document or a collection of verses.

<p>       </p>	<p>       </p>
<p>        </p>	<p>        </p>
<p>     </p>	<p>     </p>

Skender Rizaj

PRISREND UP TO THE TANZIMAT (1839)

Summary

The History of today's Prisrend dates from the Byzantium era. During the 13, 14 and 15 centuries (up to the fourth decade) Prisrend was under the power of Serbian feudal government. In this historical period Prisrend developed a lot in economic and cultural point of view. Therefore in this city lived and worked Albanians, Serbs, Wallachs, Raguzs, Sass, Kotorans, Korçullans, Splits, Zadars, Venices, Firentes. There, also acted the Consul-General (Consul generalis) of Raguza. In „Eubel Hierarchia Catholica medii aevi I” Prisrend in the XIVth century was considered a city in Albania (Pizrien in Albania).

But, Prisrend, beginning with the seventh decade of the XIVth century until its final fall under the Ottoman power (1459), was administered by Albanian excellent feudals. Once by Balshas, later by Kastriots and Dukadjins.

During the Ottoman rule, especially in the second half of the XVIIth century, Prisrend reached the peak of its economic and cultural development.

Since the end the XVth century in this city were opened many schools and a library. This library could be considered as one of the oldest library in Europe. Prisrend gave also many scientist. For example Suzi, an Albanian from Prisrend, in the XVth and XVIth wrote historical works, travels and poetry.

In that place, actually, were built different cultural and economic objects; such as cami (mosques), medrese (muslim theological schools), kütüphane (libraries), hamam (baths), han (large commercila buildings), beziştan (cloth markets), kilise (churches), etc. Citizen's handicrafts were very developed as well. From this field were known: attar (herbalists; perfumers), kazaz (silk manufactures), massah (geometers), saraç (saddlers), dellak (bath attendants; masseurs), nalband (blacksmiths), samarci (packsaddle makers), hayat (tailors), habbaz (bakers), kasap (butchers) helvacı (makers of helva-a sweet prepared in many varieties with sesame oil), berber (barbers); arabacı (makers of wheeled vehicles), ipekçi (silk merchants; silk manufacturers), dülger (carpenters; builders), kılıççı (sword sellers), kürkçü (furriers), tabak (tanners), sabunçu (soap makets), sagraç (leather markers from the rump of a horse), mutaf (makers of the articles wool of goat hair), cezveci (makers of pots with long handle for making Turkish coffee), değirmenci (millings), papuççu (makers of shoes; cobblers), çizmeci (bootmakers), çilingir (locksmiths), merdane (rollings), paşmakçı (shoemakers, blacksmiths), aşı (cooks), kuyumcu (goldsmiths), mumcu (matchlockmans), takkeci (makers and sellers of skullcaps), çerçi (peddlers), kepçeci (makers of spoons), boyacı (dyers), kazancı (cauldron makers), etc.

Domestic commerce and foreign trade were quite developed. There was trade in domestic goods as well as in imported merchandise. Exported articles, chiefly were, wool, grain, wood; whereas gold, silver, wax, horses, lead, etc. were forbidden articles for export, because they were needed for the Ottoman military government.

According to Mufassal defter (the dailed domestay book) of Prisrend (1590/91), at this city were 316 Moslem houses (Albanians, Turkies), and 284 Christian houses (Albanians, Serbs, Wallachs), totally 600 houses. While annual proceeds of inhabitants of Prisrend amounted to 50.900 akçes (aspers).

Meanwhile, according to Gjergj Bardhi (Georgius Bianki), a visitor of the Pope, Prisrend in 1641/42 had 3.120 houses: 3.000 Moslem houses (Albanians, Turkies), 80 Orthodox houses (Serbs, Albanians, Wallachs), and 40 Catholic houses.

Thus, the second half of the XVIIIth century marks the top of development of Prisrend, because in the end of the XVIIIth century, Prisrend was immensely destroyed by the Austrian-Ottoman war (1689—1690) as well as by epidemic plague.

So that, during the XVIIIth and the XIXth century though Prisrend was a little restored it never attained again the development of the XVIIth century.